



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

RAPORT

Për

Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

1 Janar – 31 Dhjetor

Viti 2017



Tiranë, Shkurt 2018

PASQYRA E LËNDËS

KRIJIMI: PËRBËRJA; PËRGJEGJËSITË, MANDATI, DETYRAT DHE FUNKSIONET E KQZ

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E DATËS 25.06.2017

I. PJESA E PARË – PERIUDHA PARAZGJEDHORE

I.1 ZONAT ZGJEDHORE	Fq. 4
I.2 PLANI I VEPRIMIT NË ZGJEDHJE	Fq. 4
I.3 AKTE TË KQZ-së	Fq. 5
I.4 BASHKËPUNIMI i KQZ-së me organet e qeverisjes vendore	
I.4.1 Përgatitja e listës së zgjedhësve	Fq. 7
I.4.2 Marrja e informacionit për qv-të, zgjedhësit në to, hartat zgjedhore, qv-të në ambiente private.	Fq. 9
I.5 BUXHETI DHE FONDET	
I.5.1 Buxheti i KQZ-së për vitin 2017	Fq.11
I.5.2 Buxheti i KQZ-së për zgjedhjet	Fq.11
I.5.3 Financimi i subjekteve zgjedhore, pjesëmarrëse në zgjedhje dhe të Partive Politike për vitin kalendarik 2017	Fq.12
I.6 PLANIFIKIMI	
I.6.1 Logjistika zgjedhore	Fq.13
I.6.2 Burimet Njerëzore në KQZ	Fq.14
I.6.3 Prokurimet	Fq.15
I.7 NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS ZGJEDHORE	
I.7.1 Ngritja e Zyrave Rajonale Zgjedhore	Fq.16
I.7.2 Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve	Fq.17
I.7.3 Ngritja dhe funksionimi i KQV-ve	Fq.18
I.7.4 Ngritja dhe funksionimi i GNV-ve	Fq.19
I.8 TRAJNIMET	
I.8.1 Zhvillimi i procedurave të përzgjedhjes së kandidaturave të trajnerëve	Fq.21
I.8.2 Zhvillimi i trajnimeve	Fq.23
I.9 INFORMIMI	
I.8.1 Edukimi i votuesve	Fq.24
I.8.2 Shoqëria	Fq.27
I.10 REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE	
I.10 Regjistrimi i partive politike në zgjedhje	Fq.28

II PJESA E DYTË – PERIUDHA ZGJEDHORE

II.1	Akreditimi i vëzhguesve	Fq.30
II.2	Monitorimi i fushatës zgjedhore dhe vëzhgimi i procesit	Fq.31
II.3	Aksesi i medias	Fq.32
II.4	Fleta e Votimit	Fq.33
II.5	Përgatitja dhe dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe dokumentacionit zgjedhor nga KQZ në KZAZ dhe nga KZAZ në KQV	Fq.34
II.6	Dita e zgjedhjeve	Fq.34
II.7	Dorëzimi i materialit zgjedhor në KZAZ-të pas mbylljes së QV-së	Fq.36
II.8	Procesi i numërimit në VNV, tabulimi dhe nxjerrja e rezultatit nga KZAZ	Fq.36
II.9	Publikimi i rezultatit paraprak, nxjerrja e rezultatit nga KQZ, rezultati përfundimtar	Fq.37
II.10	Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Kodit Penal	Fq.37
II.11	Ankimet dhe statusi i tyre	Fq.38

III PJESA E TRETË – PERIUDHA PASZGJEDHORE

III.1	Financimi i subjekteve zgjedhore	Fq.42
III.2	Analiza vjetore e punës	Fq.44
III.3	Sugjerime për përmirësime në Kodin Zgjedhor, nisur nga problematikat e hasura në zgjedhje	Fq.45

IV PJESA E KATËRT - VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-SË

IV.1	Marrëdhëniet me institucionet e tjera	Fq.46
IV.2	Partneriteti, KQZ-Organizma Ndërkombëtare	Fq.47
IV.2.1	Vëzhgimi i proceseve zgjedhore	Fq.49
IV.2.2	Përfaqësimi i KQZ-së në aktivitetet e Mekanizmave Ndërkombëtar Zgjedhore	Fq.49
IV.3	Botimi i Raportit	Fq.50

V PJESA E PESTË - PLOTËSIMI I VAKANCAVE TË KRIJUARA NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

VI PJESA E GJASHTË - ORGANIZIMI I ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KAVAJË

VII PJESA E SHTATË - VERIFIKIMI I VETËDEKLARIMEVE TË FUNKSIONARËVE PUBLIKË (DEKRIMINALIZIMI)

PJESA I – PERIUDHA PARAZGJEDHORE

I. 1 ZONAT ZGJEDHORE

Në bazë të Kodit Zgjedhor, Zonat e Administrimit Zgjedhor miratohen nga KQZ jo më vonë se 9 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, mbi bazën e numrit të shtetasve me të drejtë vote, në datën e fundit të periudhës zgjedhore për caktimin e zgjedhjeve (30 qershor ose 30 nëntor), sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Jo më vonë se 10 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon të dhënat KQZ-së, të ndara sipas njësive të qeverisjes vendore. Për zgjedhjet për Kuvendin 2017 këto të dhëna u paraqitën në KQZ nga Drejtoria e Përgjithshme të Gjendjes Civile në datën 25.11.2016.

Neni 27 i Kodit Zgjedhor përcakton kriteret ligjore për ngritjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor. Sipas kësaj dispozite, juridiksioni territorial i zonave të administrimit zgjedhor si rregull është i njëjtë me territorin administrativ të bashkisë, sipas ligjit që rregullon organizimin administrativ-territorial të Republikës së Shqipërisë. Bashkitë që kanë më shumë se 80 mijë shtetas me të drejtë vote, ndahen nga KQZ-ja, në më shumë se një zonë të administrimit zgjedhor.

Nga verifikimi i të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për numrin e shtetasve me të drejtë vote në datën 25 qershor 2017 dhe kriterëve për ngritjen e zonave të administrimit zgjedhor të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, rezultoi se 90 zonat e administrimit zgjedhor të ngritura për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2015 në aneksin e Kodit Zgjedhor, ishin në përputhje të plotë me këto kritere dhe nuk lindi nevoja për ndryshimin e tyre.

Në datën 02.12.2016 KQZ-ja miratoi ngritjen e 90 Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25.06.2017.

I.2 PLANI I VEPRIMIT NË ZGJEDHJEVE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja "gj", dhe të nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", me Dekretin nr. 9883, datë 05.12.2016, caktoi datën 18.06.2017, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Pas marrëveshjes së datës 18 maj 2017 mes dy forcave kryesore politike në vend, me Dekretin nr.10351, datë 21.05.2017 Presidenti i Republikës caktoi datën 25.06.2017, si datë për zhvillimin e Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

KQZ, në kuadër të detyrimeve ligjore lidhur me organizimin, administrimin dhe kontrollin e procesit zgjedhor, miratoi një nga vendimet më të rëndësishme për procesin zgjedhor, vendimin nr. 177 datë 09.12.2016 "Për miratimin e Planit Orientues të Veprimeve të KQZ-së për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.06.2017". Veprimet që parashikohen në këtë Plan Orientues të Veprimeve, burojnë nga detyrimet e përcaktuara nga dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe nga zbatimi i tyre në praktikë.

Plani Orientues i Veprimeve është një kornizë udhëzuese për veprimet dhe aktet nënligjore mbi të cilat mbështetet aktiviteti i mëtejshëm i KQZ-së. Plani Orientues i Veprimeve parashikon çdo

akt nënligjor, të cilin KQZ duhet ta nxjerrë në zbatim të Kodit Zgjedhor (vendime, udhëzime, akte normative dhe akte të tjera), akte nënligjore të cilat rregullojnë marrëdhënie të caktuara për herë të parë, si dhe rishikon aktet në fuqi si pasojë e ndryshimeve në ligj ose nevojave të lindura nga praktikat e mëparshme zgjedhore apo që diktohen nga rekomandimet e OSBE/ODIHR për zgjedhjet.

Detajimi i veprimeve konkrete dhe i afateve kohore, brenda të cilave duhet të ndërmerren këto veprime në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin Zgjedhor, ndihmojnë KQZ-në të kontrollojë në çdo moment ecurinë normale të procesit zgjedhor, ndihmojnë partitë politike, vëzhguesit vendas dhe të huaj, median dhe në përgjithësi publikun e gjerë, të orientohen në realizimin e procedurave dhe njëkohësisht të kontrollojnë ecurinë e procesit dhe veprimtarinë e KQZ-së.

I.3 AKTE TË KQZ-së

KQZ gjatë vitit 2017 ka nxjerr gjithësej 581 akte. Përveç akteve të nxjerra në bazë dhe për zbatim të Kodit Zgjedhor, dhe Ligjit "Për partitë politike", në kuadër të administrimit të zgjedhjeve për Kuvendin, KQZ ka nxjerr dhe akte të tjera në lidhje me zbatimin e ligjit 138/2015, akte për organizmin e zgjedhjeve të pjesëshme për Bashkinë Kavajë dhe akte në lidhje për plotësimin e vakancave të krijuara në Kuvendin e Shqipërisë.

Për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.06.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar 564 vendime.

Në raport me objektin e këtyre vendimeve, pjesa më e madhe e tyre ka shërbyer për:

- Regjistrimin e subjekteve zgjedhore në KQZ (regjistrimin e partive politike, kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit dhe listave shumëemërore);
- Miratimin e modeleve të kandidimit;
- Miratimin e strategjisë për trajnimin e komisionerëve zgjedhorë, si dhe të strategjisë për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet për Kuvendin 2017;
- Miratimin e dokumentacionit të punës për komisionet e niveleve të dyta e të treta;
- Miratimin e manualeve zgjedhore për çdo nivel të administratës zgjedhore;
- Emërime dhe zëvendësime të komisionerëve zgjedhorë;
- Miratimin e modeleve të materialeve zgjedhore;
- Monitorimi i fushatës zgjedhore në media;
- Miratimin e marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit;
- Miratimin e vëzhguesve vendorë dhe të huaj;
- Miratimin dhe nxjerrjen e rezultatit për dymbëdhjetë zonat zgjedhore;
- Ndarjen e mandateve për 12 zonat zgjedhore;
- Vendime për kërkesat ankimore.

Vendimet e KQZ-së janë të vlefshme kur votojnë pro shumica e anëtarëve të saj, me përjashtim të disa vendimeve të shprehura në mënyrë shteruese nga Kodi Zgjedhor, miratimi i të cilave kërkon votën pro të shumicës së cilësuar të 5 anëtarëve të KQZ-së.

UDHËZIME

Udhëzimet e miratuara nga KQZ gjatë vitit 2017, përcaktuan në mënyrë të qartë të gjitha procedurat që do të ndiqeshin prej subjekteve zgjedhore dhe komisioneve të niveleve më të ulta me qëllim garantimin e një procesi të drejtë zgjedhor, administrimit transparent të tij, si dhe të barazisë për të gjithë subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në të.

Në bazë të nenit 23 të Kodit Zgjedhor, aktet normative kanë karakter të përhershëm dhe zbatohen si rregull për të gjitha zgjedhjet. Këto akte rishikohen në raste të ndryshimit të ligjit apo për shkaqe të tjera që përlligjin ndryshimin e tyre.

Me ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe vendimin nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", Kuvendi i Shqipërisë ka përcaktuar detyrimin e çdo kandidati, përpara regjistrimit të tyre si të tillë, për depozitimin në KQZ të formularit të vetëdeklarimit. KQZ, me udhëzim të veçantë, miraton rregullat për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit. Sa i përket dokumentacionit të kandidimit dhe nisur nga problematikat e shfaqura në zgjedhjet e fundit, në raportin e tyre përfundimtar për monitorimin e zgjedhjeve të vitit 2015, OSBE-ODIHR kanë rekomanduar rregulla të qarta për regjistrimin e kandidatëve dhe vlefshmërinë e firmave mbështetëse.

Në lidhje me momentin e nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve nga Grupi i Numërimit dhe nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, si edhe nisur nga problematikat e shfaqura në zgjedhjet e fundit, në raportin e tyre përfundimtar për monitorimin e zgjedhjeve të vitit 2015, nga OSBE-ODIHR është rekomanduar paisja e vëzhguesve të akredituar me kopje të tabelave të rezultatit. Gjithashtu, në disa takime të organizuara nga OSBE me vëzhguesit vendorë, këta të fundit i kërkuan KQZ-së të vlerësojë mundësinë e miratimit të një vendimi të posaçëm mbi vëzhgimin e procedurave të numërimit të votave nga vëzhguesit vendorë, dhe konkretisht rekomandimi i gjashtë i tyre kërkon: "Afishimin e procesverbalit të numërimit të votave në ambientet e brendshme dhe të jashtme të Vendit të Numërimit të Votave, që vëzhguesit të kenë mundësinë ta shohin nga afër".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të kompetencave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, për çdo proces zgjedhor ngre zyra rajonale zgjedhore të përkohshme, me qëllim zbatimin e detyrave që burojnë nga ligji zgjedhor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Përmes Udhëzimit nr. 1, datë 20.02.2009, KQZ-ja ka përcaktuar mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Zyrave Rajonale Zgjedhore (ZRZ). Përvoja ka dëshmuar se për mirëadministrimin e procesit zgjedhor, numri i personelit të Zyrave Rajonale Zgjedhore duhet të përcaktohet në varësi numrit të njësive të qeverisjes vendore, të ZAZ-ve dhe qendrave të votimit të përfshira në territorin e qarkut përkatës, si edhe të relievit gjeografik të tij.

Nisur nga sa më sipër, duke qenë se ka patur ndryshime ligjore dhe shkaqe të tjera që përlligjin ndryshimin e akteve normative, KQZ-ja ka miratuar si më poshtë:

- Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 2, datë 29.01.2013, "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve";

- Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 5, datë 22.04.2015, "Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor";
- Disa ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 20.02.2009, "Për organizimin dhe funksionimin e Zyrave Rajonale Zgjedhore", i ndryshuar.

Ndryshimet ligjore që u bënë me ligjin nr. 90/2017, datë 22.05.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", urdhëronin KQZ-në të nxjerrë akte nënligjore brenda 5 ditëve nga miratimi i tij. Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, KQZ miratoi tre udhëzime, të cilat rregulluan marrëdhënie të tilla, si:

- Përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore;
- Procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve financiarë;
- Mënyrën e përlogaritjes së kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë

I.4 BASHKËPUNIMI I KQZ-SË ME ORGANET E QEVERISJES VENDORE, MARRJA E INFORMACIONIT PËR QV-TË, ZGJEDHËSIT NË TO, HARTAT ZGJEDHORE, QV-TË NË AMBIENTE PRIVATE

Në bazë të Kodit Zgjedhor, organet e qeverisjes vendore ushtrojnë detyra të rëndësishme, për administrimin e zgjedhjeve:

1.4.1 Përgatitja e Listës së Zgjedhësve, përgjegjësi e zyrave të gjendjes civile, pranë qeverisjes vendore nën drejtimin e kryetarit të bashkisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe nën drejtimin e ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

Për zgjedhjet e Kuvendit 2017, ky proces filloi në 6 dhjetor 2016. Një muaj më pas, ekstrakti i përbërësve zgjedhorë u publikua (në letër) pranë zyrave të gjendjes civile në bashki dhe elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Gjithashtu, u publikua në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së. Lista paraprake e zgjedhësve iu nënshtrua një procesi rishikimi edhe në bazë të kërkesave të zgjedhësve. Publikimi u përsërit nga organet përkatëse në mënyrë periodike çdo 30 ditë, deri në shpalljen e listës përfundimtare të zgjedhësve, 40 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Kodi Zgjedhor i ka caktuar KQZ-së rolin mbikëqyrës në procesin e hartimit të listave të zgjedhësve. Këtë rol, KQZ e ka realizuar duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësisë të qeverisjes vendore gjatë procesit të përgatitjes së listave të zgjedhësve, si edhe duke ndërhyrë kur e ka konsideruar të nevojshme. KQZ, edhe për zgjedhjet e Kuvendit 2017, mbikqyrjen e drejtëpërdrejtë në veprimet që bëhen në bazën e të dhënave të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile për hartimin e listave të zgjedhësve, e realizoi nëpërmjet dy auditëve teknikien të emëruar sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor. Veprimtaria e auditëve teknikien është rregulluar me akt normativ të miratuar nga KQZ. Raportet periodike mujore të auditëve teknikien u diskutuan në mbledhjet e KQZ-së me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore. Problemet e konstatuara gjatë diskutimit të raporteve të auditëve teknikien janë adresuar për zgjidhje në Drejtorinë e Përgjithshme të

Gjendjes Civile dhe kur ishte e nevojshme edhe në njësitë përkatëse vendore apo Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Në mënyrë të përmbledhur, problemet e nxjerra nga KQZ gjatë mbikqyrjes së përgatitjes së listave të zgjedhësve janë si më poshtë:

- Ekzistenca ende në listat e zgjedhësve, të zgjedhësve të dyshuar si të dubluar. Nga raporti i parë i auditëve teknikien shifra për zgjedhësit e dyshuar të dubluar ishte 854 ose 0.02% e zgjedhësve në listë, në listën përfundimtare ky numër u reduktua në 459 ose 0,01% e tyre. Procesi i pastrimit të listave të zgjedhësve nga rekordet e shumfishta (të dubluara) është proces i vazhdueshëm që realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe zyrat e gjendjes civile edhe në periudhë jo zgjedhore. Ky numër vazhdimisht vjen në zvogëlim.

Viti	Zgjedhës	Dublime të dyshuara		Pa kod banese	
		në ekstraktin 1	në listë	në ekstraktin 1	në listë
Zgjedhjet 2013	3.271.885	7.674	1.139	361.016	348.346
		0,23%	0,03%	11,03%	10,65%
Zgjedhjet 2015	3.370.206	3.900	1.193	312.073	300.506
		0,12%	0,04%	9,26%	8,92%
Zgjedhjet 2017	3.452.324	854	459	301.713	290.038
		0,02%	0,01%	8,74%	8,40%

- Ekzistenca ende në listat e zgjedhësve, të zgjedhësve pa kod vendbanimi. Kodi i vendbanimit është një nga përbërësit zgjedhor të zgjedhësve që është i përfshirë në përbërësit e gjendjes civile, në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Kodi i vendbanimit shërben për përcaktimin e qendrës së votimit për çdo zgjedhës. Shtetasit që nuk janë gjendur ose nuk gjenden në adresën që kanë deklaruar se banojnë, nuk kanë mundësi të pajisen me këtë kod. Kryesisht, zgjedhësit pa kod vendbanimi janë ata që kanë emigruar jashtë shtetit. Megjithë përpjekjet e bëra nga njësitë e qeverisjes vendore, numri i zgjedhësve pa kod vendbanimi është ende i lartë. Në raportimin e ekstraktit të parë të përbërësve zgjedhor me mungesë të këtij kodi ishin 301.713 zgjedhës, ndërsa në listën përfundimtare të zgjedhësve pa këtë kod ishin 290.038 zgjedhës ose 8,40% e gjithë zgjedhësve.
- Krijimi i panevojshëm i qendrave të reja të votimit, në kundërshtim me kriteret ligjore nga disa kryetarë të njësisë vendore. Sipas Kodit Zgjedhor kur një zonë qendre votimi ka mbi 1000 zgjedhës, kryetari i njësisë qeverisjes vendore, vendos për krijimin e qendrës së votimit shtesë brenda të njëjtës zonë. Kur një qendër votimi ka nën 200 zgjedhës e bashkon atë me qendrën e votimit më të afërt. Në procesin e përgatitjes së listës së zgjedhësve u konstatuan disa raste të shkeljes së këtyre kriterëve. Me ndërhyrjen e KQZ-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile ky fenomen në listën përfundimtare u normalizua. Në ekstraktin e parë ishin 106 qendra votimi me mbi 1000 zgjedhës dhe 386 me nën 200 zgjedhës, në ekstraktin e parafundit atë të muajit Prill 2017 ishin përkatësisht 10 dhe 187 qendra votimi, ndërsa në listën përfundimtare ky numër ishte zero.
- Mospërfshirja e një numri të konsiderueshëm zgjedhësish në listën e zgjedhësve të institucioneve të vuajtjes së dënimeve. KQZ bashkëpunoi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe vetëm një numër i vogël zgjedhësish në këto institucione iu desh të votonin me vendim gjykate, ndryshe nga zgjedhjet e vitit 2015, ku për zgjedhësit me vendim gjykate, me vendim të KQZ-së u ngritën dy qendra votimi të posaçme, një ditë para ditës së zgjedhjeve.

- Nevoja e bërjes së disa modifikimeve në sistemin teknologjik qendror në administrimin e listës së zgjedhësve sipas disa kërkesave logjike, me synimin për të lehtësuar përdorimin nga punonjësit e zyrave të gjendjes civile dhe për të mos lejuar bërjen prej tyre të disa gabimeve që duan mund dhe kohë për t'u korigjuar nga qendra.

1.4.2. Veç detyrës për hartimin e listës së zgjedhësve, Kodi Zgjedhor ngarkon kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore:

- të caktojë zonat dhe vendndodhjet e qendrave të votimit;
- krijimin e një qendre votimi shtesë kur një zonë qendre votimi ka më shumë se 1000 zgjedhës dhe bashkimin me një zonë tjetër të një zone qendre votimi që ka më pak se 200 zgjedhës;
- përgatitjen e hartës zgjedhore për çdo zonë qendre votimi;
- t'i propozojë KQZ-së për të miratuar qendra votimi në ambiente private sipas kriterëve që përcakton Kodi Zgjedhor, dhe të detajuar nga KQZ me akt normativ, etj.

Për ushtrimin e këtyre detyrave KQZ me Udhëzimin nr.1, datë 12.12.2012, "Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet", ka përcaktuar në mënyrë të detajuar detyrat dhe afatet e realizimit të tyre nga njësitë e qeverisjes vendore.

Afatet kohore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor për përmbushjen e këtyre detyrave nga kryetarët e bashkive, referojnë si pikënisje dekretin e Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe përmbyllen:

- Brenda 30 ditëve për krijimin (ndarjen) apo bashkimin e qendrave të votimit dhe për ngritjen e qendrave të votimit të posaçme;
- Brenda 30 ditëve caktimin dhe shpalljen e vendndodhjes së qendrës së votimit;
- Brenda 40 ditëve njoftimin e KQZ-së për vendndodhjen e qendrës së votimit (njoftim i cili duhet të shoqërohet me planimetrinë, llojin e objektit, etj).


Përvoja ka dëshmuar se mosnjohja e mirë e ligjit nga nëpunësit e administratave vendore dhe afatet e ngushta kohore brenda të cilave veprohet për të përmbushur përgjegjësitë, bëhen shkak për zgjidhje të vonuara dhe të sforcuara, veçanërisht sa i përket propozimeve për caktimin e qendrave të votimit në ndërtesa private në mungesë të objekteve publike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgjatë vitit 2016 realizoi takime konsultative në të gjithë bashkitë e vendit me qëllim marrjen e masave në kohë dhe dhënien e zgjidhjeve efektive për probleme të ndryshme. Kryetarëve të bashkive dhe prefektëve të qarqeve, iu vunë në dispozicion të dhëna për objektet zgjedhore brenda territoreve përkatëse, si edhe në kuadër të bashkëpunimit u kërkua verifikimi i gjendjes së të gjithë objekteve që përdoren për qendra votimi. Gjithashtu, i'u kërkua vëmendje për aksesin e personave me aftësi ndryshe. Kjo qasje e re e KQZ-së, në mënyrën e organizimit dhe administrimit të fazës parazgjedhore të procesit zgjedhor të vitit 2017, i shërbeu forcimit të bashkëpunimit me organet e qeverisjes vendore dhe bashkërendimit të punës për përmbushjen në kohë të detyrave.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, menjëherë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve, adresoi për të gjithë kryetarët e bashkive kërkesën për dërgimin e të dhënave të kërkuara për caktimin dhe vendndodhjen e qendrave të votimit. Kërkesa u ripërsërit shkresërisht dhe publikisht, për të shmangur vonesat dhe paplotësitë në dërgimin e informacionit. KQZ ofroi asistencë për

përgatitjen dhe mënyrën e dërgimit të të dhënave të kërkuara. Nga kryetarët e 61 bashkive u propozua caktimi i vendodhjes në ndërtesa private për 433 qendra votimi ose 8% e numrit të përgjithshëm të qendrave të votimit. Për 259 qendra votimi propozohej vendndodhje në të njëjtën ndërtesë private sikundër në zgjedhjet vendore 2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të propozimeve, caktoi vendodhjen e 400 qendrave të votimit në ndërtesa private. Numri më i vogël i qendrave të votimit të ngritura në ndërtesa private për zgjedhjet 2017, dëshmon për eficientë e projektit të realizuar nga KQZ në fazën parazgjedhore përgjatë vitit 2016.



Probleme si: moskryerja e verifikimeve paraprake për të konfirmuar kushtet e ambientit të propozuar dhe dakortësinë e pronarit për vënien në dispozicion të ambientit për qendër votimi, ishin shkaqet kryesore për të cilat nga disa kryetarë të bashkive u kërkuua dhënia e autoriimeve për ndryshim të vendodhjes së QV-ve.

Në periudhën 40 ditë para datës së zgjedhjeve, KQZ dha autorizim për ndryshimin e vendndodhjes së 59 qendrave të votimit, nga të cilat:

- 32 që ishin caktuar në ndërtesa publike (vendodhjet e reja u caktuan po në ndërtesa publike);
- 19 që ishin caktuar në ndërtesa private (vendodhjet e reja u caktuan po në ndërtesa private);
- 7 qendra votimi që ishin caktuar në ndërtesa publike (vendodhjet e reja u caktuan në ndërtesa private);
- 1 qendër votimi që ishte caktuar në ndërtesë private (vendodhja e re u caktua në ndërtesë publike).

Për të gjitha këto raste, KQZ urdhëroi kryetarët e bashkive të kryenin menjëherë njoftimin me shkrim të zgjedhësve, si dhe të afishonin listat e zgjedhësve pranë vendodhjeve të caktuara të qendrave të votimit.

Në zgjedhjet për Kuvendin 2017, si rezultat i ndarjes së re administrative-teritoriale (61 bashki nga 383 bashki dhe komuna që ishin më parë), përgjithësisht njësitë e qeverisjes vendore vepruan më me përgjegjshmëri për përmbushjen e detyrave të tyre për zgjedhjet. Këtë fakt e dëshmon, mosvendosja nga KQZ e sanksioneve administrative me gjobë për asnjë nga kryetarët e bashkive. Në zgjedhjet e vitit 2013 dhe ato të vitit 2015, KQZ ka vendosur sanksione administrative me gjobë përkatësisht për 129 dhe 31 kryetarë të njësisive të organeve të qeverisjes vendore, të cilët nuk zbatuan dispozitat e Kodit Zgjedhor.

I.5 BUXHETI DHE FONDET

I.5.1 Buxheti i KQZ-së për vitin 2017

Për vitin 2017, KQZ-së ju vunë në dispozicion 139,300 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim dhe administrim" për shpenzimet e administratës për paga dhe sigurime, shpenzime për mallra dhe shërbime si edhe për shpenzime kapitale.

Në zbatim të buxhetit të akorduar u realizuan procedurat prokurorese për sigurimin e bazës materiale për funksionim e institucionit, konform legjislacionit në fuqi të prokurimeve publike. Në fondet e miratuara në buxhetin e institucionit për vitin 2017, përfshihej edhe fondi për rikostruksionin e një prej magazinave të bazës materiale në Lundër si edhe blerja e një automjeti të ri në funksion të veprimtarisë së KQZ-së. Fondet, të cilat u celën në kohë nga Ministria e Financave, u prokuruan nga KQZ dhe në përfundim u realizua rikonstruksion i magazinës së bazës materiale në Lundër si edhe blerja e automjetit.

Me qëllim përballimin efektit të rritjes së pagave, e cila u bë me VKM nr.187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civilë, zv/ministrave dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, të aparateve të ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorisë së Përgjithshme, disa Institucioneve të Pavarura, Institucione në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, të Institucioneve në varësi të Ministrive të Linjës dhe administratën e Prefektit", si edhe VKM nr.202, datë 15.03.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucione buxhetore", KQZ-së ju vunë në dispozicion 10 milionë lekë shtesë në buxhetin e institucionit për vitin 2017.

I.5.2 Buxheti i KQZ-së për zgjedhjet

Me ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", Komisionit Qendror të Zgjedhjeve iu akordua një fond prej 600 milionë lekësh për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë 2017.

Kodi Zgjedhor, parashikonte risi edhe sa i përket infrastrukturës që do të përdorej për zgjedhje, realizimi i së cilave përkonte me një kosto financiare më të madhe nga ajo e parashikuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin nr.38, datë 09.02.2017, miratoi strukturën e shpenzimeve buxhetore për Kuvendin e Shqipërisë të datës 18 qershor 2017, duke parashikuar një strukturë buxhetore në shumën totale prej 733 milionë lekë, (nr. zgjedhësve 3.461.956) me kosto për një zgjedhës rreth 1.6 euro.

KQZ e motivuar për ruajtjen dhe përmirësimin e standarteve zgjedhore, eliminimin e të gjitha dobësive potenciale që mund të shkaktohen gjatë një procesi zgjedhor për shkaqe ekonomiko-financiare, kërkoi shtesë fondi në programin e zgjedhjeve, shtesë e cila u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.388, datë 03.05.2017 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017 dhe financimin e partive pjesmarrëse në këto zgjedhje....", në shumën 133 milion lekë.

Duke analizuar strukturën buxhetore të zgjedhjeve të përgjithshme rezultoi se 9.39 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe kontribute të sigurimeve

shoqërore të personelit të përkohshëm, 29.50 % e fondit është akorduar për pagesën e komisionerëve të të gjitha niveleve, 61.11 % të fondeve është akorduar për shpenzime për mallra dhe shërbime.

Fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit u përdorën me efikasitet në përputhje me legjislacionin në fuqi për manaxhimin e fondeve publike. Nga 733 milionë lekë të akorduara, u realizuan 676 milionë lekë ose 91.6% e fondeve të akorduara. Diferenca prej 62 milionë lekësh konsiston në 4.3 milionë lekë në zërin paga për personelin e përkohshëm, dhe 49 milionë lekë në zërin shpenzime për mallra dhe shërbime.

Tabela e fondeve buxhetore të parashikuara & realizuara, zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2017,

					ne mije/leke
-	paga	sigurime	shperblime	mallra/sherbime	totali
fondet e parashikuara	59,077	9,805	216,365	448,304	733,551
fondet e realizuara	50,069	8,361	211,765	389,612	659,807

I.5.3 Financimi i partive politike, pjesmarrëse në zgjedhje dhe partive politike për vitin kalendarik 2017

Neni 87/1 i Kodit Zgjedhor përcakton se subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, financohen nga fonde publike dhe jopublike. Fondet publike për këtë qëllim vihen në dispozicion nga buxheti i shtetit dhe ndahen me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas formulës së përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Për fushatën zgjedhore, zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2015, Këshilli i Ministrave me VKM nr.388, datë 03.05.2017 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017 dhe financimin e partive pjesmarrëse në këto zgjedhje...", akordoi shumën prej 65 milionë lekësh për t'ju shpërndarë partive politike pjesmarrëse në zgjedhje. KQZ shpërndau fondin prej 65 milionë lekësh, partive pjesmarrëse në zgjedhje me vendimin nr.341, datë 31.05.2017 "Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që do t'u shpërndahet si paradhënie partive politike të regjistruara si subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017", bazuar në përcaktimet e nenit 87/3 të Kodit Zgjedhor.

Me daljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, fondi prej 65 milionë lekësh u rishpërnda nga KQZ me vendimin nr.558, datë 31.07.2017 "Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që përfitojnë partitë politike të regjistruara si subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017".

Për ushtrimin e aktivitetit normal të tyre, partitë politike financohen nga buxheti i shtetit. Ligji për partitë politike ngarkon KQZ-në të përcaktojë masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore.

Ligji nr.130/2016, "Per buxhetin e vitit 2017", parashikoi fondin prej 290 milionë lekësh si mbështetje financiare për partitë politike për vitin 2017. Neni 19, pika 2, e Ligjit "Për partitë

politike”, i ndryshuar, përcakton rregullat sipas së cilave bëhet shpërndarja e fondeve vjetore për partitë politike:

- a) 70 për qind, sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Çdo parti parlamentare përfiton ndihmë financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në bazë të sistemit zgjedhor të parashikuar në Kodin Zgjedhor;
- b) 20 për qind, në mënyrë të barabartë, ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare
- c) 10 për qind, sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë vendi.

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 për qind dhe u ndahet partive parlamentare.

KQZ me vendimin nr.28 datë 24.01.2017, vendosi shpërndarjen e 100% të shumës së akorduar nga buxheti i shtetit partive politike për vitin 2017, 12 partive politike që përfitonin nga llogaritja. Çelja e fondeve partive politike, në zbatim të ligjit “Për partitë politike”, u bë pas dorëzimit të raporteve financiare vjetore nga ana e partive politike.

I.6 PLANIFIKIMI

I.6.1 Logjistika Zgjedhore

Logjistika Zgjedhore funksionon mbi bazën e një sistemi të centralizuar të organizimit, përpunimit, transportit dhe mbledhjes së dokumentacionit dhe materialeve zgjedhore. Për shkak të afateve ligjore që përcakton Kodi Zgjedhor, sigurimi dhe përpunimi i materialit zgjedhor brenda një kohe shumë të shkurtër mbetet një sfidë me të cilën KQZ përballet në çdo proces zgjedhor. Për përmbushjen e detyrave të saj, KQZ bashkëpunoi me institucione që kanë mundësi të garantojnë një infrastrukturë të tillë, siç është Ministria e Mbrojtjes, si dhe Policinë e Shtetit për shoqërimin e materialeve zgjedhore në të gjitha vendet e përcaktuara. KQZ, në respektim të urdhërimeve dhe afateve kohore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, realizoi me sukses shpërndarjen e materialeve zgjedhore dhe fletët e votimit në 90 Zonat e Administrimit Zgjedhor. Respektimi i këtij afati erdhi si rezultat i planifikimit në kohën e duhur të infrastrukturës së logjistikës zgjedhore dhe të bazuar në një sistem të organizuar nga përvoja e krijuar në vite dhe duke garantuar një standard të përmirësuar të përgatitjes dhe administrimit të logjistikës zgjedhore.

Infrastruktura për përgatitjen e logjistikës zgjedhore

- *Infrastruktura logjistike e KQZ-së:*

Hapësirat që KQZ ka në administrim për përgatitjen e logjistikës zgjedhore janë të mjaftueshme për të përballuar kërkesat në specifikë/sasi për materiale zgjedhore si dhe përgatitjen e tyre në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor. Rikonstruktimi i magazinës në Lundër lehtësoi në mënyrë thelbësore gjithë procesin e përgatitjes së BMZ për qendrat e votimit dhe grupet e numërimit të votave.

- *Infrastruktura për ZRZ-të, KZAZ-të dhe KQV-të:*

Materialet dhe dokumentacioni bazë që përgatitet për procesin zgjedhor, kryesisht për KZAZ-të dhe KQV-të është i përcaktuar në detaje nga Kodi Zgjedhor, fakt që nuk lë hapësirë për problematikë. KZAZ-të u pajisën me dokumentacion, pajisje bazë dhe materiale zgjedhore në kohën e duhur dhe nuk pati asnjë problem për funksionimin e operativitetit të dërgimit apo marrjes së informacionit. Në lidhje me infrastrukturën e KQV-ve, KQZ u fokusua dhe për krijimin e kushteve për personat me aftësi të kufizuara. Qendrat e votimit u pajisën me dhoma të fshehtësisë për të siguruar të drejtën e votës personave me aftësi të kufizuara dhe me fletë votimi/maskë për votuesit e verbër.

I.6.2 Burimet Njerëzore në KQZ

KQZ në kryerjen e funksioneve të saj ndihmohet nga administrata e KQZ-së, e cila përbëhet nga nëpunës të shërbimit civil dhe punonjës mbështetës.


Administrata KQZ-së përbëhet nga 71 punonjës. Shtimi i organikës së administratës në vitin 2017 erdhi si domosdoshmëri për zbatimin e një sërë kompetencave të shtuara KQZ-së, si (i) kontrolli, auditimi dhe monitorimi financiar i partive politike gjatë vitit kalendarit dhe fushatës zgjedhore, si dhe (ii) zbatimi i ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Me vendimet nr.29 dhe nr.168 të vitit 2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e KQZ-së nr.110 datë 12.09.2002, "Për miratimin e strukturës, organikën dhe numrin e punonjësve të administratës së KQZ-së", i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve solli ndryshime në rritjen e numrit të përbërjes së administratës në 71 punonjës, përkundëjt administratës së mëparshme me 55 punonjës. Për pozicionet e punës të krijuara gjatë vitit 2017 janë ndjekur të gjitha procedurat sipas rregullave dhe dispozitave ligjore në fuqi për rekrutimin e nëpunësve. Janë rekrutuar 14 pozicione pune me status të nëpunësit civil dhe 4 pozicione pune trajtuar me kodin e punës.

Gjatë një viti zgjedhor apo në periudha të tjera, KQZ rekruton edhe punonjës shtesë me kohë jo të plotë për të kryer funksione specifike që lidhen me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

KQZ, në Janar 2017 mbi bazën e një planifikimit të nevojave për shtesë të burimeve njerëzore për zgjedhjet për Kuvendin 2017, filloi rekrutimin e 342 punonjës me kontratë pune me afat të caktuar. Punonjësit e rekrutuar iu nënshtruan një trajnimi 2 ditor, për njohjen e procesit të punës, nga punonjësit e drejtorive përkatëse.

Në periudhën kohore Maj-Qershor 2017 u nënshkruan kontrata pune për 281 trajnues nga të cilët, 54 trajnues të komisioneve të administrimit të zonave zgjedhore, 280 trajnues të komisioneve të qendrave të votimit dhe 94 trajnues të grupeve të numerimit të votave.

Strukturë-Organika e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me ndryshimet përkatëse



Totali: 71 punonjës

Trajnimi i vazhdueshëm profesional

Pjesa më e madhe e trajnimeve në vitin 2017 janë kryer trajnime specifike të një pjesë të stafit të KQZ-së, e lidhur kryesisht tematika me detyrat e tyre funksionale, si:

- Dixhitalizimi i dosjeve të nëpunësve civil, në bashkëpunim me DAP-in për sistemin e pagave online.
- Klasifikimi dhe ruajtja e dokumentacionit organizuar nga Arkivi i Shtetit.
- Mirëqeverisja dhe antikorrupsioni, organizuar nga ASPA në bashkëpunim me koordinatorin kombëtar për antikorrupsionin.
- Trajnim me koordinatorin për të drejtën e informimit.
- Trajnimi për modulet e sistemit HRMS, për sistemin e pagave që do kalojnë on-line.

Gjithashtu në bashkëpunim me roganizmat ndërkombëtare KQZ ka organizuar një sërë aktivitete mbi financat e partive politike dhe fushatave elektorale. Këto aktivitete janë në mbështetje të KQZ-së në rritjen e forcimit e kapacitetve për të monitoruar financimin e fushatës zgjedhore.

I.6. 3 Prokurimet

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në funksion të misionit për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, ka detyrimin ligjor për sigurimin e të gjithë bazës logjistike zgjedhore (mallra dhe shërbime). Duke qënë se në pjesën më të madhe të tyre logjistika zgjedhore përdoret vetëm për zgjedhjet e rradhës (fletë votimi, kode sigurie, zarfa dhe procesverbale etj.), sigurimi i tyre kërkon zhvillimin e procedurave prokuruese.

Për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2017, u zhvilluan 11 procedura prokurimi nga të cilat 3 të llojit "kërkesë për propozim elektronike" dhe 8 procedura të llojit "procedurë me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës". Në përfundim të procedurave prokuruese me operatorët fitues u nënshkruan kontrata dhe u lëvrua malli apo shërbimi i kërkuar.

Edhe pse në një periudhë kohore mjaft të ngjeshur u realizuan të gjitha procedurat e prashikuara dhe përgjithësisht mallrat u lëvruan brenda afateve kohore të pritshme, ç'ka ndihmoi në përpunimin, përgatitjen dhe shpërndarjen e bazë materiale të logjistikës zgjedhore drejt komisioneve të niveleve të tjera (KZAZ, KQV).

Në përfundim, si rezultat zhvillimit në kohë të këtyre procedurave, baza materiale logjistike nuk rezultoi problematike në mbarëvajtjen e këtyre zgjedhjeve.

I.7 NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

I.7.1 Ngritja e Zyrave Rajonale Zgjedhore

Kodi Zgjedhor, përcakton kompetencë të KQZ-së ngritjen e Zyrave Rajonale Zgjedhore të përhershme apo të përkohshme me qëllim zbatimin e detyrave që burojnë nga ligji zgjedhor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Zyrat Rajonale Zgjedhore shërbejnë për të vendosur një koordinim dhe komunikim më të mirë dhe më efikas midis KQZ-së dhe komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, subjekteve zgjedhore dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, në funksion të mire-administrimit të procesit zgjedhor dhe rritjes së transparencës në veprimtarinë e KQZ-së.

KQZ-ja, me akt normativ ka përcaktuar mënyrën e organizimit dhe funksionimit, të drejtat dhe detyrimet e Zyrave Rajonale Zgjedhore, rregullat për komunikimin me të tretët. Në vlerësim të eksperiencës dhe mirëadministrimit të procesit zgjedhor, KQZ vlerësoi se numri i personelit të Zyrave Rajonale Zgjedhore duhet të përcaktohet në varësi numrit të njësisve të qeverisjes vendore, të ZAZ-ve, qendrave të votimit të përfshira në territorin e qarkut përkatës dhe relievit gjeografik të tij. Për këto shkaqe, KQZ miratoi disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin "Për ngritjen dhe funksionimin e Zyrave Rajonale Zgjedhore".

KQZ në datën 17.01.2017 vendosi ngritjen e Zyrave Rajonale Zgjedhore në 12 qarqet e vendit. Personeli i këtyre zyrave në qarqet Tiranë, Elbasan, Vlorë, Fier, përbëhej nga tre inspektorë rajonalë ndërsa në tetë qarqet e tjera, personeli i tyre përbëhej nga dy inspektorë rajonalë. Përzgjedhja e inspektorëve rajonalë u bë mbi bazë të njohurive të tyre për procesin zgjedhor, njohjes së terrenit, eksperiencës e tyre sa i përket mënyrës së menaxhimit të problematikave, etj. Vendodhja dhe adresat e këtyre zyrave, emrat e inspektorëve dhe kontaktet e tyre u publikuan në faqen e internetit të KQZ-së.

Zyrat Rajonale Zgjedhore funksionuan përgjatë periudhës 18 shkurt - 18 korrik 2017. KQZ angazhoi pranë këtyre zyrave edhe 12 persona me aftësi të kufizuar si ndihmësinsektorë, 8 prej tyre e kishin ushtruar këtë detyrë edhe në zgjedhjet vendore të vitit 2015.

Zyrat Rajonale Zgjedhore dhanë një ndihmesë të madhe në organizimin e punës dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme, duke kontaktuar vazhdimisht me organet e pushtetit lokal, drejtoritë e ndryshme Rajonale, Institucionin e Prefektit dhe Nënprefektit si dhe institucionet e tjera shtetërore për të cilat Kodi Zgjedhor përcakton detyra konkrete për mbarëvajtjen dhe

sigurinë e procesit zgjedhor. E një rëndësie të veçantë evidentohet puna e Zyrave Rajonale për monitorimin e punës së KZAZ-ve, koordinimin e punës së KZAZ-ve më organet e pushtetit vendor, dhënien e konsulencës ligjore dhe zgjedhore për KZAZ-të, inspektimin e ambienteve private të propozuara për qendra votimit, inspektimin e përgatitjeve për përshtatjen e ambienteve dhe krijimin e kushteve për vendet e numërimit të votave, si dhe inspektime të ndryshme sipas problematikës së hasur gjatë procesit zgjedhor apo të kërkuar nga KQZ.

I.7.2 Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve

KQZ në datën 16.02.2017, përcaktoi partitë politike që do të paraqesnin propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve dhe vendosi datën 5 mars 2017, si afat për të paraqitur propozimet për anëtarët e tyre. Brenda këtij afati, paraqitën kandidaturat dhe dokumentacionin përkatës për anëtarë të KZAZ-ve vetëm partitë e shumicës parlamentare konkretisht; Partia Socialiste e Shqipërisë (PS) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI). KQZ pas kryerjes së verifikimeve për plotësimin e kriterëve ligjore, në datën 15.03.2017 emëroi 225 anëtarë dhe 45 sekretarë të KZAZ-ve të propozuar nga PS, dhe 90 anëtarë të KZAZ-ve propozuar nga LSI.

Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ përcaktojnë se Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ngrihet dhe funksionon kur ka në detyrë shumicën e anëtarëve të saj (katër anëtarë) dhe sekretarin. Vakancat në përbërjen e KZAZ-ve, të krijuara për shkak të mosparaqitjes së propozimeve nga partitë politike të opozitës parlamentare, pamundësuan konstituimin në afat të KZAZ-ve. KQZ, në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", publikoi për tre ditë me radhë, në gazetën me tirazh më të madh kombëtar dhe në faqen zyrtare të KQZ-së, kërkesën për shprehje interesi nga shtetas të gatshëm për të ushtruar detyrën e anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së. Në këtë kërkesë, përcaktoheshin kushtet dhe kriteret që duhet të plotësonin shtetasit e interesuar, dokumentacioni për të provuar përmbushjen e kërkesave të ligjit dhe afati për paraqitjen e tij.


Në KQZ, paraqitën kërkesë të shoqëruar me dokumentacion ligjor 213 shtetas të gatshëm për të ushtruar detyrën e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ. KQZ në datën 03.04.2017, miratoi listën emërore të 200 shtetasve, të cilët plotësonin kriteret për t'u emëruar kryesisht nga KQZ anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve. Anëtari i katërt, për 45 KZAZ që renditen me numër çift, dhe sekretari, për 45 KZAZ-të që renditen me numër tek, u emëruan kryesisht nga KQZ duke përzgjedhur në mënyrë rastësore shtetas nga lista emërore e miratuar.

Konstituimi dhe mbledhja e parë e 90-të KZAZ-ve u krye në mënyrë korrekte, pavarësisht vështirësive që sillte numri i kufizuar i anëtarëve në detyrë, ku edhe vetëm një mungesë do të përbënte shkak për cënimin e kuorumit dhe për pasojë mos konstituimin e KZAZ-së. KQZ, mbi bazën e propozimeve të KZAZ-ve, emëroi kryetarët e KZAZ-ve me numër tek, dhe zëvendëskryetarët e KZAZ-ve me numër çift, pozicione që sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor i përkisnin të propozuarave nga Partia Socialiste.

Partia Demokratike, paraqiti propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve më datë 30 dhe 31 maj 2017. Partia Republikane, paraqiti propozimet për anëtarë të KZAZ-ve më datë 8 qershor 2017. Kodi Zgjedhor në nenin 29, pika 5, përcakton se anëtarët e KZAZ-ve të emëruar kryesisht qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e anëtarëve të propozuar nga partitë politike,

sipas këtij neni. KQZ, bazuar në përcaktimet e dispozitës sipërcituar, liroi nga detyra anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve të emëruar kryesisht dhe emëroi anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve të propozuar nga Partia Demokratike dhe anëtarët e KZAZ-ve të propozuar nga Partia Republikane. KQZ, mbi bazën e propozimeve të KZAZ-ve, emëroi kryetarët e KZAZ-ve me numër çift dhe zëvendëskryetarët e KZAZ-ve me numër tek, pozicione që sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor i përkisnin të propozuarave nga Partia Demokratike. Përbërja e KZAZ-ve ishte e plotë, ishin emëruar të gjithë anëtarët dhe sekretarët sipas propozimeve të partive politike.

Angazhimi i komisionerëve zgjedhorë me eksperiencë të mëparshme zgjedhore u evidentua në propozimet e të katër partive politike. Konkretisht, nga 720 anëtarë të KZAZ-ve, 286 prej tyre kishin eksperiencë si anëtarë të KZAZ-ve në zgjedhjet pararendëse.



Në bazë të kërkesave të partive politike u zëvendësuan 131 ose 18% e anëtarëve të KZAZ-ve, kundrejt 37% në zgjedhjet e 2015, dhe 35% në zgjedhjet e 2013.


Partia Socialiste zëvendësoi 76 komisionerë, 65 prej të cilëve gjatë muajit qershor 2017. Partia Demokratike zëvendësoi 28 komisionerë gjatë muajit qershor 2017. Lëvizja Socialiste për Integrim zëvendësoi 18 komisionerë, 14 prej të cilëve gjatë muajit qershor 2017. Partia Republikane zëvendësoi 9 komisionerë gjatë muajit qershor 2017.

Partitë politike që kanë detyrimin për respektimin e kuotës gjinore në propozimet për anëtarësinë e KZAZ-ve e tejkaluan atë në propozimet e para dhe në propozimet në vijim për lirim-emërim të anëtarëve të KZAZ-ve.

Partitë politike që propozuan anëtarët e KZAZ-ve	Propozimet fillestare		Në përfundim të procesit, pas lirim-emërimeve	
	Numri i anëtareve të KZAZ-ve	Në përqindje	Numri i anëtareve të KZAZ-ve	Në përqindje
Partia Socialiste e Shqipërisë	97	35.9 %	100	37.0 %
Partia Demokratike	90	33.3 %	94	34.8 %
Lëvizja Socialiste për Integrim	14	15.6 %	11	12.2 %
Partia Republikane	14	15.6 %	14	15.6 %
Në total	215	29.9 %	219	30.4 %

Nga 720 anëtarë të KZAZ-ve, 215 ose 29.9% ishin gra në propozimet fillestare, dhe pas lirim/emërimeve të kërkuara nga partitë politike numri i grave ishte 219 ose 30.4% e anëtarësisë së KZAZ-ve, nga të cilat 23 ushtruan detyrën e Kryetares, 18 të Zëvendëskryetares, 24 të sekretares dhe 154 ishin anëtare.

Në tre proceset e fundit zgjedhore, përfaqësimi i grave në përbërjen e KZAZ shënon tendencë në rritje.



Partia Socialiste e Shqipërisë propozoi 270 anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, 97 ose 35.9 % prej tyre ishin gra. Pas lirim/emërimeve të kërkuara të kërkuara nga kjo parti, kuota gjinore nuk u cënua. Në përfundim të procesit zgjedhor, 100 ose 37 % e anëtarëve të KZAZ-ve të propozuar nga PS ishin gra, nga të cilat:

- 11 ushtruan detyrën e Kryetares së KZAZ-së;
- 10 ushtruan detyrën e Zv/Kryetares së KZAZ-së;
- 16 ushtruan detyrën e Sekretares së KZAZ-së;
- 63 ushtruan detyrën e anëtares së KZAZ-së.

Partia Demokratike propozoi 270 anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, 90 ose 33.3 % prej tyre ishin gra. Pas lirim/emërimeve të kërkuara nga kjo parti, kuota gjinore nuk u cënua. Në përfundim të procesit zgjedhor, 94 ose 34.8 % e anëtarëve të KZAZ-ve të propozuar nga PD ishin gra, nga të cilat:

- 12 ushtruan detyrën e Kryetares së KZAZ-së;
- 8 ushtruan detyrën e Zv/Kryetares së KZAZ-së;
- 8 ushtruan detyrën e Sekretares së KZAZ-së;
- 66 ushtruan detyrën e anëtares së KZAZ-së.

Lëvizja Socialiste per Integrim propozoi 90 anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, 11 ose 12.2 % prej tyre ishin gra.

Partia Republikane propozoi 90 anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, 14 ose 15.6 % prej tyre ishin gra.

Zëvendësimet e kërkuara nga PS dhe PD nuk cënuan respektimin e kotës gjinore. LSI kërkoi lirin e 4 grave anëtare të KZAZ dhe emëroi 1 grua. Partia Republikane nuk kërkoi zëvendësimin e asnjë anëtareje të KZAZ-së. Respektimi i kuotës gjinore sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor edhe për këtë proces zgjedhor dëshmoi se nuk realizon përfaqësimin 30% të grave në çdo KZAZ. Në 57 KZAZ përfaqësimi i grave ishte nën kuotën 30% ndërkohë që në zgjedhjet vendore 2015, në 58 KZAZ përfaqësimi i grave ishte nën 30%.

KZAZ-të përgjithësisht përmbushën detyrat e tyre me profesionalizëm. Në këtë aspekt, ndihmoi mirëorganizimi dhe realizimi i trajnimit të këtyre komisionerëve nga ana e KQZ-së, i cili dha impakt të drejtpërdrejtë në mirë administrimin e procesit nga këto komisione, brenda sferës së kompetencave të tyre. Testimi i njohurive në përfundim të procesit të trajnimit dëshmoi për nivel shumë të mirë të kuptimit të ligjit zgjedhor në përgjithësi dhe detyrave, përgjegjësi, e


procedurave konkrete të KZAZ-ve në veçanti. Katër raste ku u tentua të deklaroheshin të "parregullta" kuti votimi të marra në dorëzim të rregullta, kishin të bënin me qëndrime dhe vullnete individuale të komisionerëve, dhe jo më mos kuptimin e ligjit dhe procedurave ligjore. KQZ, përdori të gjithë autoritetin e vet ligjor, dhe procedurat u zbatuan në mënyrë korrekte.

I.7.3 Ngritja dhe funksionimi i KQV-ve

Për zgjedhjet për Kuvendin u ngritën 5362 Komisione të Qendrave të Votimit. Në respektim të afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, KZAZ-të duhej të emëronin anëtarët, kryetarët dhe sekretarët e KQV-ve brenda datës 29.05.2017, dhe në çdo rast jo më vonë se data 5.06.2017. Plotësimi i përbërjes së KZAZ-ve me propozimet e partive politike, vetëm më datë 8 qershor 2017, ndikoi në paraqitjen e vonuar të propozimeve të anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit.

KQZ, në mënyrë të vazhdueshme i bëri apel dhe thirrje publike partive politike për problematikat që po shkaktonin në organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor duke mos paraqitur propozimet dhe dokumentacionin përkatës për anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit. Opinioni publik u informua përmes deklaratave për KZAZ-të ku po pengohej ky proces, dhe ju bë me dije emrat e partive politike që nuk po përmbushnin detyrimin ligjor për të dorëzuar propozimet për anëtarë të KQV-ve.

Më datë 21 qershor 2017, katër ditë para ditës së zgjedhjeve, 24 KZAZ nuk kishin emëruar ende anëtarët e KQV-ve për shkak të mosparaqitjes së propozimeve nga partitë politike. Ndërkohë KQZ kishte shpërndarë bazën materiale zgjedhore në të gjitha KZAZ-të, të cilat duhet t'ia shpërndanin atë komisioneve të qendrave të votimit jo më vonë se ora 15.00 e datës 24.06.2017. Sjellja e partive politike duke paraqitur propozime në tejkalim të skajshëm të afateve ligjore, çënoi jo vetëm realizimin e trajnimeve nga KQZ, por edhe organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor. Tabela më poshtë jep të dhëna për numrin e KZAZ-ve, sipas datës kur kanë disponuar me vendime emërimin e komisionerëve të qendrave të votimit.




KQV-të në të gjithë vendin përgjithësisht respektuan orarin e hapjes dhe mbylljes së qendrave të votimit, duke kryer korrektësisht procedurat përkatëse po ashtu edhe gjatë ditës së votimit. Fakti se vetëm 2 kuti votimi në të gjithë territorin e Shqipërisë u konsideruan si të parregullta nga ana e grupeve të marrjes në dorëzim, si dhe një numër tejet i vogël i kutive të materialeve zgjedhore që iu nënshtruan procesit të verifikimit, për shkak të mos gjetjes së PV- KQV-08 tek kutia e votimit, dëshmojnë për zbatimin me korrektesë të procedurave nga komisionerët e nivelit të tretë.

I.7.4. Ngritja dhe funksionimi I GNV-ve

Për zgjedhjet për Kuvendin u caktuan 866 Grupe të Numërimit të Votave. Në respektim të afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, brenda datës 15.06.2017 KZAZ-të duhej të kishin emëruar anëtarët e grupeve të numërimit të votave. Edhe në këto zgjedhje, sikundër në të gjithë zgjedhjet pararendëse, partitë politike përgjithësisht i paraqitën propozimet për anëtarë të GNV-ve vetëm përpara fillimit të procesit të numërimit.

Grafiku më poshtë jep të dhëna për numrin e KZAZ-ve, sipas datës kur kanë disponuar me vendimarrje emërimin e anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave.



1.8 TRAJNIMET


1.8.1 Zhvillimi i procedurave të përzgjedhjes së kandidaturave të trajnerëve

KQZ, përmes miratimit të "Strategjisë së trajnimit të komisionerëve zgjedhorë për zgjedhjet për Kuvend 2017", synoi mirorganizimin e trajnimit për të gjithë nivelet e administratës zgjedhore. Përmes këtij dokumenti strategjik, që planifikonte kohën, metodologjitë dhe materialet trajnuese për trajnimin e administratës zgjedhore të të gjithë niveleve, synohej ngritja e nivelit profesional të komisionerëve zgjedhorë, në funksion të mbarëvajtjes së procesit në zonën e administrimit zgjedhor, në qendrën e votimit dhe në vendin e numërimit të votave.


Për sigurimin e kapaciteteve të nevojshme profesionale për realizimin e kurseve dhe sesioneve të trajnimit për të gjithë administratën zgjedhore, KQZ-ja angazhoi trajnerë nga të gjithë qarqet, të cilët u përzgjedhën mbi bazën e një konkurimi të hapur dhe transparent. Trajnuesit e KZAZ-ve KQV-ve dhe GNV-ve, pas trajnimit dhe testimit të njohurive nga administrata e KQZ-së në Tiranë realizuan trajnimin e komisionerëve të niveleve të dyta dhe të treta sipas skemave me shtrirje gjeografike në të gjithë vendin për të siguruar ofrimin e trajnimit pranë çdo komisioneri zgjedhor.

Grafikët më poshtë japin të dhëna për trajnuesit e KZAZ-ve dhe GNV-ve në proceset zgjedhore 2009-2015-2017.


TË DHËNA PËR TRAJNERËT E KZAZ-VE



TË DHËNA PËR TRAJNERËT E KQV-VE



TË DHËNA PËR TRAJNERËT E GNV-VE



1.8.2 Zhvillimi i trajnimeve

KQZ miratoi Manualet e Trajnimit për KZAZ, KQV dhe GNV, të cilat trajtuan temat e përcaktuara në këtë Strategji. Manualet e trajnimit, qartësuan procedurat duke ndërthur përcaktimet e Kodit Zgjedhor me detajimet e akteve normative dhe kuadrin nënligjor të miratuar nga KQZ për këtë proces zgjedhor.

“Udhëzuesi praktik për detyrat e anëtarëve të KQV-së”, një material i ri i përdorur në këto zgjedhje, u hartua për t’i ardhur në ndihmë komisionerëve të qendrave të votimit. Ky Udhëzues, në format (xhepi) lehtësisht të përdorshëm, shërbente si kujtesë për kryerjen në kohën e caktuar dhe me korrektesë të procedurave nga komisionerët e qendrave të votimit. Detyrat e kryetarit, sekretarit dhe anëtarëve të KQV-së, të grupuara në seksione të veçanta, lehtësisht të dallueshme sipas pozicionit dhe kohës së kryerjes së tyre, synonin të qartësonin komisionerët për mënyrën e kryerjes së tyre, dhe përmes shënimeve të siguroheshin për përmbushjen korrekte të detyrës.

Trajnimi dhe testimi i njohurive për 720 anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve u realizua më 7.06.2017, menjëherë pas plotësimit të përbërjes së KZAZ-ve me propozimet e partive politike të opozitës parlamentare.

Trajnimi i anëtarëve të KQV-ve u planifikua në datat 17-23 qershor 2017. Falë bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit trajnimet për anëtarët e KQV-ve u realizuan në ambientet e shkollave.

Datat e Sesionave të Trajnimit të anëtarëve të KQV-ve	Numri i pjesëmarrësve	PS	PD	LSI	PR	Komisionere
17.06.2017	1565	785	413	337	30	433
18.06.2017	2007	923	609	422	53	437
19.06.2017	2066	1088	585	353	40	495
20.06.2017	2151	1042	736	320	53	512
21.06.2017	2317	1210	835	225	47	583
22.06.2017	1876	1056	612	180	28	457
23.06.2017	958	508	355	72	23	216
Në total	12940	6612	4145	1909	274	3133

Trajnimi i anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave, ishte planifikuar në datat 23-24 qershor 2017. Për shkak të propozimeve tejet të vonuara nga partitë politike, emërimi i anëtarëve të GNV përgjithësisht u krye përpara fillimit të procesit të numërimit të votave. Trajnimi i numëruesve u krye në Vendet e Numërimit të Votave përpara fillimit të numërimit.

Në rang vendi, u ngritën 866 grupe të numërimit të votave, dhe u emëruan 3 464 numërues të grupeve të para dhe të dyta të numërimit. 84% e numëruesve u trajnuan, numëruesit që nuk morën trajnim i përkasin grupeve të dyta të numërimit, të cilët nuk u angazhuan në proces.

Datat e sesioneve të trajnimit për anëtarët e GNV	Numri i pjesëmarrësve	Gra	PS	PD	LSI	PR	PDIU
23.06.2017	103	9	38	31	19	9	5
24.06.2017	677	109	195	165	180	66	93
25.06.2017	1033	109	294	272	245	0	106
26.06.2017	1104	140	268	299	259	163	122
27.06.2017	114	6	23	36	25	30	9
Totali	3031	380	765	803	728	268	335

Në sesionet e trajnimit të KZAZ-ve dhe KQV-ve, vëmendje e veçantë iu kushtua trajtimit të temave për garantimin e fshehtësisë së votës [ndalimin e votimit familjar dhe në grup, rastet e fotografimit të votës], ndalimin e votimit më shumë se një herë (timbrimi), për zgjedhësit që për arsye fizike nuk mund të votojnë vetë etj., të cilat u demonstruan përmes simulimeve.

I.9. INFORMIMI

I.9.1 Edukimi i votuesve

KQZ përmes miratimit të strategjisë për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet për Kuvendin 2017, në përgjigje të nevojave për informim dhe sensibilizim të shtetasve dhe specifikave të grupimeve me nevoja të veçanta, përcaktoi projektet e përgjithshme dhe ato specifike që do të realizoheshin, metodologjinë, mjetet dhe kohën për realizimin e tyre. Projektet synonin shpërndarjen e informacionit të plotë për procesin zgjedhor, ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e të gjithë zgjedhësve për pjesëmarrje në votime.

Aktivitetet në Ditën Botërore të Zgjedhjeve - të enjen e parë të muajit shkurt - shënuan një moment të rëndësishëm për edukimin zgjedhor të të rinjve. Në kuadër të simbolikës së kësaj dite, maturanët të shkollave të mesme "Asim Vokshi", "Petro Nini Luarasi" dhe "Ismail Qemali" vizituan ambientet e KQZ-së dhe bashkëbiseduan me anëtarët e KQZ-së për vlerën e votës dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje. Salla e Trajnimeve në KQZ funksionoi si qendër votimi ku u simulua procesi i votimit, duke i njohur të rinjtë me detyrat dhe përgjegjësitë e komisionerëve zgjedhorë dhe vëzhguesve gjatë procesit të votimit. Leksioni i hapur i Kryetarit të KQZ-së për studentët e Universitetit të Mjekësisë, "shëruesit" e nesërm, synoi rritjen e vetëdijes qytetare të studentëve për rëndësinë e zgjedhjeve demokratike dhe për parandalimin e femoneve negative që çënojnë ato.

"Votoni! Është e drejta juaj të zgjidhni!" ishte slogani që KQZ-ja përdori në fushatën edukuese për zgjedhjet e datës 25 qershor 2017 si një mesazh sensibilizues për çdo votues. Realizimi i harmonizuar i programeve të ndryshme edukuese, informuese dhe sensibilizuese, gjetja e drejtimeve, formave e mjeteve sa më eficiente të komunikimit me votuesit, synoi realizimin e objektivave strategjikë të mëposhtëm:

- Shpërndarjen e informacionit të plotë për procesin zgjedhor;
- Informimin dhe sensibilizimin e zgjedhësve për rëndësinë e ushtrimit të së drejtës së votës në mënyrë të lirë, të fshehtë dhe të pandikuar;

- Informimin e zgjedhësve si dhe për veprat penale që çënojnë zgjedhjet demokratike;
- Ndërgjegjësimin e zgjedhësve për të drejtat dhe detyrimet e tyre në procesin zgjedhor;
- Realizimin apo përshtatjen e programeve edukuese, ndërgjegjësuere, sensibilizuese dhe informuese për grupime specifike shoqërore si votues për herë të parë, gra dhe vajza, persona me aftësi të kufizuar, etj.;
- Rritjen e besimit të votuesve tek administrimi i procesit zgjedhor;
- Rritjen e pjesëmarrjes në votime.

Përmes transmetimit të spoteve televizivë, katër të prodhuar nga vetë KQZ, një në bashkëpunim me OSBE-në, dhe një në bashkëpunim me UN Women, dhe dy spoteve radiofonike, KQZ realizoi komunikimin me zgjedhësit në të gjithë territorin e vendit, për:

- Shpërndarjen e informacionit të plotë zgjedhor: llojin e zgjedhjeve, për çfarë votohet, data, orarin e votimit, procedurat e votimit, të drejtat dhe detyrimet e zgjedhësit;
- Sensibilizimin e zgjedhësve për të marrë pjesë në votime, si ushtrim i së drejtës kushtetuese dhe detyrim qytetar ndaj shoqërisë dhe forcimit të demokracisë në vend;
- Forcimin e kulturës zgjedhore tek zgjedhësit për të ushtruar të drejtën e votës si shprehje e vullnetit individual, si e drejtë kushtetuese dhe detyrim qytetar, si edhe rritjen e vetëdijes qytetare të zgjedhësve për denoncimin e çdo rasti që synon të abuzojë me këtë të drejtë kushtetuese.

Në spotet audiovizive të transmetuara për zgjedhjet e datës 25 qershor 2017, u dha informacion i plotë për veprat penale që çënojnë votën e lirë dhe demokratike dhe masën e dënimit për to, duke pasqyruar dispozitat përkatëse, pas shtesave e ndryshimeve të Kodit Penal me Ligjin 89/2017. Përmes spoteve audiovizive iu bë publicitet numrit telefonik pa pagesë, aplikacionit "VOTO 2017", si mjete në dispozicion të zgjedhësve për të marrë informacion zgjedhor dhe ku mund të kryheshin raportime për raste të cënimit të votës së lirë dhe demokratike.

Të gjithë spotet televizive ishin të përshtatur me gjuhën e shenjave për të siguruar aksesin në informacion të zgjedhësve që nuk dëgjojnë. Nevojat specifike të zgjedhësve me aftësi të kufizuar për tu informuar për procedurat që ndjek ky grupim në votim, si dhe mesazhi sensibilizues i KQZ për të marrë pjesë në votime, u trajtuan me një spot të veçantë. Si pjesë e projekteve specifike për edukimin zgjedhor të zgjedhësve gra, një spot i veçantë televiziv adresoi mesazhe sensibilizuese për zgjedhëset gra të të gjitha moshave dhe profesioneve, të zonave rurale dhe ato shtëpiake, për pjesëmarrje në votime dhe ushtrimin e të drejtës së votës në mënyrë vetjake dhe të pandikuar nga vullneti i anëtarëve të tjerë të familjes.

KQZ prodhoi fletëpalosje në format xhepi dhe në format A3 me informacion zgjedhor dhe ilustrim grafik të procedurave të votimit. Fletëpalosjet u shpërndanë përmes pikave të informimit dhe në të gjithë pikat e kalimit kufitar për informimin e shtetasve shqiptarë me vendbanim jashtë vendit.

Postera të ndryshëm u afishuan në ambientet zgjedhore dhe hyrjet pranë tyre (Zyrat Rajonale Zgjedhore, selitë e komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor dhe në çdo qendër e votimi) dhe kishin informacion:

- *edukues për procedurat e votimit*, i cili demonstronte me fjalë dhe realizim grafik të gjithë procedurat që ndjek zgjedhësi në qendrën e votimit;
- *sensibilizues për pjesëmarrje në votime*, i realizuar në tre koncepte grafike për qasje ndaj zgjedhësve të rinj, grave dhe të moshuarve, me mesazhe sensibilizuese për pjesëmarrje në

votime dhe pasqyrim të dispozitave për veprat penale që çenojnë votën e lirë dhe demokratike dhe masën e dënimit për to.

- *informues* për çfarë ndalohet në qendrën e votimit, rastet kur zgjedhesi e humb te drejtën e votimit;

- *ndërgjegjësues*, për sanksionet për komisionerët zgjedhorë në rast të moszbatimit të ligjit.

Posterat u publikuan në mënyrë të alternuar në gazeta si një nga mjetet efikase për komunikim me zgjedhësit. Postera të mëdhenj (bill-board) në rrugët kryesore nacionale dhe reklamat e ndriçuara (city lights) në qytetet kryesore, përmes logos dhe slloganit të zgjedhjeve, synonin sensibilizimin e zgjedhësve për pjesëmarrje në votim.

Për zgjedhjet për Kuvend 2017 u krijuan 12 pika të informimit zgjedhor për komunikim të drejtpërdrejtë me zgjedhësin të cilat funksionuan në 12 qytete qendër qarku. Pikat e informimit të lëvizshme që funksionuan gjatë muajit qershor 2017 ofruan informacion zgjedhor nëpërmjet materialeve edukuese dhe informuese të prodhuara (fletëpalosjeve dhe manual për zgjedhësin). Pranë tyre u angazhuan të rinj studentë të cilët u trajnuan për t'ju përgjigjur pyetjeve të ndryshme lidhur me zgjedhjet.

Faqja zyrtare e KQZ-së, shërbeu edhe për këto zgjedhje për komunikim me votuesit, kryesisht votuesit e rinj. Rubrika "Hapat që ndjek zgjedhësi gjatë ditës së votimit", prezantoi të gjithë materialet e projekteve të përgjithshme (spote, postera, fletëpalosje) në formë interaktive dhe si një paketë e plotë informative. Informimi i shtetasve për mundësinë për të ndjekur 'on line' të gjitha mbledhjet e KQZ-së, krijoi mundësinë që çdo i interesuar të kuptojë përgjegjësitë ligjore dhe si funksionon institucioni, si dhe të ndjekë hap pas hapi ecurinë e procesit zgjedhor, administrimin, dhe rezultatet e tij. Materiale të ndryshme promociionale si bluza, kapele, stilolapsa, stema, aromatizues makine, mbajtëse çelësash, me logon dhe slloganin e zgjedhjeve, stema dhe adresën elektronike të KQZ -së u shpërndanë për zgjedhësit në pikat e informimit zgjedhor dhe në sesionet e edukimit të organizuara nga KQZ.

Për edukimin zgjedhor të komunitetit rom u realizua një projekt të veçantë. 25 studentë romë nga të 12 qarqet e vendit u trajnuan nga administrata e KQZ-së dhe u aftësuan për të zhvilluar sesione edukimi zgjedhor në komunitet. Të rinjtë e trajnuar, në bashkëpunim me administratën e KQZ-së realizuan mbi 22 sesione edukimi zgjedhor në vendqëndrimet e komunitetit rom në qarqet Gjirokastrë, Lezhë, Durrës, Delvinë, Berat, Fier, Korçë, Tiranë, Elbasan, Shkodër, Pogradec.

Në këto sesione morën pjesë rreth 856 anëtarë të komunitetit rom nga të cilët 432 ishin femra, ndërsa 328 ishin meshkuj. Studentët rom të angazhuar si trajnerë, ishin në ndihmë të komunitetit gjatë muajit qershor 2017 për të orientuar zgjedhësit për qendrat e votimit ku ishin të regjistruar, vendodhjen e tyre, si dhe për adresimin e problemeve të ndryshme të komunitetit në prag zgjedhjesh, përfshirë edhe tentativa për blerjen e votës. Në sesionet e edukimit numri i kontaktit të trajnerit i'u vendos në dispozicion pjesëmarrësve për të raportuar çdo situatë që mund të pengonte pjesëmarrjen e lirë në zgjedhje.

Ky projekt, solli përfitime të prekshme për procesin e votimit, por gjithashtu synoi lënien e një trashëgimie afatgjatë në komunitet, nëpërmjet trajnimit me parimet themelore demokratike, për trajnimin e anëtarëve të komunitetit si të bëjnë zgjedhjen e tyre, dhe si të vlerësojnë mbajtjen e përgjegjësive nga përfaqësuesit e tyre politikë.

Për votuesit për herë të parë, KQZ në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Politike dhe Ministrinë e Arsimit zbatoi program ndërgjegjësues dhe informues në 385 shkolla e mesme në të

gjithë vendin. Programi u zbatua në muajt prill - maj 2017 dhe adresoi 35 000 nxënës të shkollave të mesme - votues për herë të parë.

Aplikacioni "VOTO 2017" synoi informimin dhe komunikimin interaktiv kryesisht për votuesit e rinj që janë edhe përdoruesit më të shumtë të teknologjisë së informacionit. Ky aplikacion, i lidhur me faqen zyrtare të KQZ-së, krijoi mundësinë për marrjen e informacionit për Listën e Zgjedhësve, qendrën e votimit dhe vendodhjen e saj; informacion për administrimin e procesit zgjedhor, për ditën e zgjedhjeve, procesin e numërimit dhe rezultatet. Aplikacioni mundësonte gjithashtu raportimin në kohë reale përmes fotografive apo videove për mashtrime elektorale, intimidimin e votuesve apo praktika të tjera të kundraligjshme. Për votuesit që nuk kishin mundësi përdorimit të aplikacionit KQZ vendosi në dispozicion numrin e telefonit pa pagesë. Në të gjithë posterat dhe fletëpalosjet u publikua gjithashtu adresa e aplikacionit dhe numri telefonik i kontaktit.

KQZ, me synim nxitjen e pjesëmarrjes së grave në votim realizoi një spot të veçantë televiziv, i cili u transmetua gjatë muajit qershor 2017 në fasha orare me audiencë të lartë, i cili përcolli për zgjedhëset gra të të gjitha moshave dhe profesioneve, gratë e zonave rurale dhe gratë shtëpiake, informacione dhe mesazhe sensibilizuese për pjesëmarrje në votim dhe ushtrimin e të drejtës së votës në mënyrë të pandikuar.

KQZ, realizoi dhe transmetoi një spot televiziv për zgjedhësit me aftësi ndryshe. Përmes këtij spoti, ky grupim zgjedhësish u informuan për mënyrën e përdorimit të shablloneve/maskave me alfabetin brail, për procedurat që ndiqen nga zgjedhësi që ndihmon një zgjedhës tjetër, kush mund t`i japë ndihmën zgjedhësit që për arsye fizike nuk mund të votojë vetë, si dhe detyrimin e zgjedhësit që jep ndihmën për të mos shtrembëruar vullnetin e zgjedhësit.

Në bashkëpunim me Prezencën e OSBE dhe Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë, u organizua për zgjedhës që nuk shikojnë - votues për herë të parë trajnimi tre ditor "Të votojmë në mënyrë të pavarur dhe të fshehtë".

Gjithashtu, të gjithë spotet televizivë që prodhoi KQZ për zgjedhjet për Kuvendin 2017 u përshtatën me gjuhën e shenjave për të siguruar aksesin në marrjen e informacionit nga zgjedhësit që nuk dëgjojnë. Në të gjithë qendrat e votimit u afishuan postera me informacion për zgjedhësit me aftësi të ndryshe me qëllim informimin e tyre edhe në qendrën e votimit, si edhe të komisionerëve zgjedhorë për procedurat dhe mjetet specifike që përdor ky grupim në votim.

1.9.2 Shoqëria

Bashkëpunimi me shoqërinë civile edhe për zgjedhjet për Kuvendin në 2017, ishte në focus të KQZ-së kryesisht për veprimtaritë për edukimin zgjedhor, ku më të rëndësishme evidentohen:

- Bashkëpunimi me Institutin e Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA) për hartimin e projekteve edukuese të përshtatura për specifikat e komunitetit rom, dhe për realizimin e sesioneve të edukimit zgjedhor në të gjithë vendqëndrimet e komunitetit;
- Bashkëpunimi me Akademinë e Studimeve Politike për zbatimin e projektit për edukimin e votuesve të rinj në të gjithë shkollat e mesme të vendit;
- Bashkëpunimi me Institutin e të verbërve "Visum" i cili dizenjoi maskën me alfabetin braile, si dhe informoi zgjedhësit që nuk shikojnë për mënyrën e përdorimit të saj;
- Bashkëpunimi me ADRF, për realizimin e projekteve edukuese për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, përzgjedhjen dhe trajnimin e 12 persona me aftësi të kufizuara që u angazhuan pranë Zyrave Rajonale Zgjedhore;

- Bashkëpunimi me shoqatat "Prespa", "Romani Paxi", për përkthimin e materialeve edukuese në gjuhët greke, maqedonase, vllahe, dhe rome.

I.10 REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

I.10.1 Regjistrimi i partive politike / kandidatëve

Në mbështetje të nenit 64 Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacion, i cili vërteton regjistrimin si parti politike në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, emrin e partisë, shkronjat nistore të partisë, emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, financierit dhe të personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në.

- Regjistrimi i partive politike

Pas daljes së Dekretit të Presidentit të Republikës, nr. 10351, datë 21.05.2017, 46 parti politike i respektuan afatin dhe kriteret ligjore për tu regjistruar si subjekte zgjedhore në zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë 2017. Pas marrëveshjes së datës 18 maj 2017 mes dy forcave kryesore politike në vend, me Dekretin nr.10351, datë 21.05.2017, Presidenti i Republikës caktoi datën 25.06.2017, si datë për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Pas daljes së Dekretit, u regjistruan si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë 2017 edhe 3 parti politike të tjera.

Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017 nuk u regjistrua asnjë koalicion zgjedhor.

- Regjistrimi i kandidatëve

Në bazë të nenit 67, pika 1 të Kodit Zgjedhor, 18 partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, depozituan kërkesat për regjistrimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për deputetë. KQZ me vendimet përkatëse miratoi listat shumëmemërore të kandidatëve për deputetë për 18 parti politike, si më poshtë:

1. FRYMA E RE DEMOKRATIKE
2. PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE
3. ALEANCA DEMOKRATIKE
4. ALEANCA POPULLORE PËR DREJTËSI
5. PARTIA DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET
6. SFIDA PËR SHQIPËRINË
7. PARTIA ALEANCA DEMOKRISTIANE
8. ALEANCA ARBNORE KOMBËTARE
9. MINORITETI ETNIK GREK PËR TË ARDHMEN
10. PARTIA KRISTIAN DEMOKRATE
11. LISTA E BARABARTË
12. PARTIA SOCIALDEMOKRATE
13. PARTIA KOMUNISTE E SHQIPËRISË
14. LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM
15. PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË
16. PARTIA DEMOKRATIKE
17. PARTIA REPUBLIKANE SHQIPTARE
18. PARTIA BASHKIMI DEMOKRISTIAN SHQIPTAR

Gjithësej në Zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 qershor 2017 u regjistruan 2666 kandidat. Në bazë të nenit 67, pika 6 të Kodit Zgjedhor, për çdo zonë zgjedhore të paktën 30% (tridhjetë për qind) e listës shumemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumemërore duhet t'i përkasin secilës gjini. Në rast të shkeljes së kriterit të gjinisë në përbërjen e listave të kandidatëve për deputetë, KQZ vendos sanksione administrative.

Gjithashtu, në rast të krijimit të vendeve bosh në Kuvend, KQZ vendos dhe sanksione plotësuese, duke plotësuar çdo vend bosh me kandidatin e radhës të gjinisë më pak të përfaqësuar, pavarësisht renditjes në listë.

Në zgjedhjet për Kuvendin 2017, për shkak të mosplotësimit të kriterit të kuotave gjinore në listat shumemërore të kandidatëve për deputet, KQZ vendosi sanksion administrative me gjobe në masën 1 milion leke për Partinë Socialiste, 1 milion lekë për Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim. dhe në masën 12 milion lekë për Partinë Demokratike.

Të dhëna për kandidatët për deputetë sipas qarqeve

Nr.	Subjekti politik		kandidatë	Femra	%	Meshkuj	%
1	Lëvizja Socialiste për Integrim	LSI	146	62	42,47%	84	57,53%
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	161	57	35,40%	104	64,60%
3	Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë	PKD	140	57	40,71%	83	59,29%
4	Sfida për Shqipërinë	SFIDA	140	60	42,86%	80	57,14%
5	Partia Republikane Shqiptare	PR	141	64	45,39%	77	54,61%
6	Partia Demokratike	PD	194	39	20,10%	155	79,90%
7	Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar	PBDKSH	151	62	41,06%	89	58,94%
8	Partia Aleanca Demokristiane	ADK	140	63	45,00%	77	55,00%
9	Partia Social Demokrate e Shqipërisë	PSD	143	56	39,16%	87	60,84%
10	Aleanca Demokratike	AD	145	50	34,48%	95	65,52%
11	Fryma e Re Demokratike	FRD	150	71	47,33%	79	52,67%
12	Partia Demokracia Sociale	PDS	141	61	43,26%	80	56,74%
13	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	PDIU	144	65	45,14%	79	54,86%
14	Aleanca Arbnore Kombëtare	AAK	141	53	37,59%	88	62,41%
15	Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	MEGA	140	54	38,57%	86	61,43%
16	Partia Komuniste e Shqipërisë	PKSH	143	68	47,55%	75	52,45%
17	Aleanca Popullore për Drejtësi	APD	143	69	48,25%	74	51,75%
18	Lista e Barabartë	LIBRA	163	62	38,04%	101	61,96%
Shuma në rang vendi			2666	1073	40.25%	1593	59,75%

Të dhëna për deputetët e zgjedhur

Nr.	Subjekti politik		Deputetë	Femra	%	Meshkuj	%
1	Lëvizja Socialiste për Integrim	LSI	19	5	26,32%	14	73,68%
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	74	22	29,73%	52	70,27%
3	Partia Demokratike	PD	43	11	25,58%	32	74,42%
4	Partia Social Demokrate e Shqipërisë	PSD	1	0	0,00%	1	100,00%
5	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	PDIU	3	1	33,33%	2	66,67%
Shuma në rang vendi			140	39	27,14%	101	72,86%

PJESA II – PERIUDHA ZGJEDHORE

II.1 Akreditimi i vëzhguesve


Vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë

Kodi Zgjedhor u mundëson vëzhguesve vendas dhe atyre ndërkombëtarë të monitorojnë procesin zgjedhor në çdo fazë dhe moment të tij. Subjektet zgjedhore konkurruese, kandidatët, organizata jofitimprurëse, organizmat ndërkombëtarë, ambasadat dhe media kanë të drejtë të kenë vëzhgues në çdo qendër votimi.

Për vëzhgimin e zgjedhjeve për kuvend 2017, u angazhuan një numër relativisht i lartë vëzhguesish si vendas ashtu dhe të huaj. Për ndjekjen e procedurave të akreditimit të vëzhguesve vendas dhe të huaj, u bazuam në Udhëzimin e KQZ-së Nr.13, datë 22.04.2009, mbi përcaktimin e rregullave të vëzhgimit të procesit zgjedhor, akreditimit, të drejtat dhe detyrat, kriteret dhe standardet për vëzhgimin e zgjedhjeve nga organizatat jofitimprurëse shqiptare, organizmat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave.

Në zgjedhjet për kuvend të datës 25 qershor 2017 u akredituan 5351 vëzhgues të huaj dhe vendas nga të cilët: 914 janë vëzhgues afatgjatë, 3362 janë vëzhgues afatshkurtër, 327 janë përkthyes dhe 748 janë përfaqësues të medias.

KQZ shpreh mirënjohjen e saj për të gjithë vëzhguesit vendas dhe ndërkombëtar të cilët me përkushtimin dhe prezencën e tyre masive kanë qenë burim sigurie për zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe sigurisht që me gjetjet dhe rekomandimet e tyre do jenë program pune për KQZ-në në drejtim të përmirësimit të performancës së saj në të ardhmen.



II. 2 Monitorimi i fushatës zgjedhore dhe vëzhgimi i procesit.

KQZ pas shqyrtimit të propozimeve të ardhura nga Organizatat joFitimprurëse, vendosi ngritjen e Bordit të Monitorimit të Medias. Gjatë zgjedhjeve për Kuvendin, BMM-ja monitoroi 15 operatorë radio-televizivë dhe paraqiti 30 raporte ditore pranë KQZ-së, ndërsa 4 raporte javore u shqyrtuan nga KQZ-ja në mbledhje të hapura.

BMM-ja konstatoi se operatorët televizivë të monitoruar nuk e kishin respektuar kohën e transmetimit të fushatës zgjedhore të partive politike dhe propozoi masën administrative "kompensim i kohës televizive" në favor të partive politike. Bordi i Monitorimit dhe vetë operatorët kanë hasur vështirësi lidhur me respektimin e balancimit kohor dhe, në shumë raste, imbalancat e konstatuara kanë ndodhur në mënyrë krejt të paqëllimshme, për shkak të specifikave në fushatat e subjekteve të ndryshme.

Shqetësim për KQZ-në mbetet shtrirja e monitorimit mbi të gjithë operatorët audiovizivë, pasi në Shqipëri ekzistojnë 70 televizione lokale dhe kombëtare, 71 radio lokale dhe kombëtare, ndërkohë që Autoriteti i Medias Audiovizive ka në dispozicion vetëm 15 monitoret për të monitoruar vetëm 15 operatorë audiovizivë.

KQZ në dy javët e para të monitorimit nuk miratoi propozimet e BMM për vendosjen e gjobave për TV por iu dha kohë operatorëve audio-vizivë që të kompensonin kohën (pavarësisht se Kodi Zgjedhor kompensimin e kohës e parashikon vetëm për televizionin publik shtetëror, RTSH), duke shmangur dënimin e TV-ve dhe duke përcjellë mesazhin se mediat mund të respektonin Kodin Zgjedhor pa u dënuar me gjoba. Dënimi i TV-ve me gjoba nga ana e KQZ-së mund të çonte deri në mbylljen e aktivitetit të operatorëve audio-vizivë, ndaj KQZ gjykoj se televizionet mund të kompensonin kohën për subjektet.

Vitet e fundit në Shqipëri po aplikohen platformat televizive online (televizione vetëm ne website interneti), të cilat mbeten jashtë monitorimit të BMM-së, pasi Kodi Zgjedhor parashikon vetëm monitorimin e operatorëve audiovizivë të cilët janë nën juridiksionin e Autoritetit të Medias Audiovizive.

Epoka e teknologjisë së informacionit ka ndikuar edhe në përzgjedhjen e formatit për të bërë fushatë elektorale nga ana e partive politike, duke e zhvendosur nga mediat tradicionale në mediat sociale dhe ato online. Fushata zgjedhore e vitit 2017 u përqëndrua më shumë në Websitet e televizioneve dhe gazetave online, të cilët transmetuan spote, reklama dhe programe audio dhe video, pasi tashmë pajisjet "smart", mundësojnë shpërndarjen e informacionit tek publiku në çdo kohë dhe pa kufizime.

Pasqyrimi i fushatës elektorale në mediat sociale dhe ato online nuk monitorohet nga BMM-ja pasi mungon kuadri ligjor dhe kjo ka sjellë jo vetëm pabarazi të pasqyrimin të fushatës për partitë politike dhe kandidatët e pavarur, në aspektin e hapësirës mediatike që u jepet atyre, por dhe të kostove financiare që zbatohen në mënyrë preferenciale.

Kodi Zgjedhor rregullon hapësirën mediatike që duhet t'i jepet çdo partie politike apo kandidati të pavarur në radio dhe televizion, ndërsa neni 84 i tij, përcakton se mediat audiovizive duhet të bëjnë transparente dhe të aplikojnë të njëjtat tarifa monetare për të njëjtin segment kohor për çdo parti apo kandidat i pavarur. Ligji "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin 90/2017 në datën 22.05.2017, përcaktoi se reklammat e partive politike duhet të transmetoheshin falas dhe pa pagesë nga ana e operatorëve audiovizive. Ky ndryshim ligjor solli përplasje të

dispozitive të këtij ligji me Kodin Zgjedhor, duke nxitur reagimin e Shoqatës së Mediave dhe nevojën për të harmonizuar dispozitat e ligjit "Për partitë politike" dhe Kodit Zgjedhor.

Për të garantuar mbulim korrekt dhe profesional të fushatave zgjedhore, në raportin e tij përfundimtar Bordi i Monitorimit të Medias rekomandoi:

- Krijimin e mundësive për një trajnim më profesional të monitoruesve në Tiranë e në rrethe;
- Mundësimin e infrastrukturës për monitorimin e operatorëve me transmetim nga rrethet. Aktualisht, monitorimi i operatorëve me transmetim nga rrethet paraqitet shumë problematik për shkak të mungesës së kësaj infrastrukture, duke çuar në raportime shpesh jo korrekte të cilat bëjnë të pamundur marrjen e masave për të garantuar një mbulim profesional;
- Plotësimin dhe saktësimin e terminologjisë në dispozitat e Kodit Zgjedhor për të pakësuar paqartësitë dhe hapësirat për interpretime subjektive, duke filluar që nga elementët më themelorë si për shembull, çfarë përbën imbalancë të raporteve kohore, etj;
- Zëvendësimin e parimit të balancimit kohor me parimin e aksesit të barabartë dhe vënies së kohës në dispozicion.

II.3 Aksesi i medias

Transparenca e veprimtarisë së KQZ-së, për vet misionin që ky institucion përmbush, është një nga garancitë për rritjen e besimit të publikut në procesin zgjedhor. Veçanërisht në një vit zgjedhor, interesimi i publikut dhe medias për aktivitetin e KQZ-së rritet ndjeshëm. Pasqyrimi i zgjedhjeve nga media është një faktor vendimtar në zhvillimin e zgjedhjeve demokratike pasi qëllimi final i pasqyrit në media i veprimtarisë së KQZ-së dhe fushatës zgjedhore, është informimi i drejtë i votuesve dhe transparenca për publikun.

Media pasqyron aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor, shpërndan informacion mbi vendimmarrjen e KQZ, platformat e partive politike apo kandidatëve të pavarur dhe informacion që edukon zgjedhësit shqiptar.

Seancat e mbledhjeve të KQZ janë përherë publike, kanë gjithmonë vëmendjen dhe praninë e medias dhe mund të ndiqen drejtpërdrejt nga faqja zyrtare e internetit të KQZ-së. Në kuadër të kësaj transparence, KQZ ka përdorur të gjitha mënyrat e komunikimit për njoftuar rregullisht dhe në kohë, jo vetëm subjektet zgjedhore, por edhe të gjitha mediat e shkruara dhe audiovizive. Të gjitha njoftimet për mbledhjet e KQZ-së, nuk janë thjesht të karakterit formal për kohën e zhvillimit të tyre, por shoqërohen përherë me dokumentacionin përkatës, objekt shqyrtimi në rendin e ditës. Përgjithësisht, kjo transparencë ndihmoi në mirë- informimin e opinionit publik, por ka patur raste që si rezultat i mosnjohjes apo moskuptimit të ligjit zgjedhor, vendimmarrja e KQZ-së nuk u përcoll në mënyrë të saktë dhe korrekte.

Në zgjedhjet e datës 25.06.2017, ishte risi publikimi që KQZ i bëri listave shumemërore të kandidatëve në faqen zyrtare përmes aplikacionit "Kandidatët", ku shfaqej formulari i vetëdeklarimit dhe jetëshkrimi (CV), duke ofruar mundësinë publikut të njihet me kandidatët të cilët garonin në zgjedhje.

Ashtu si në zgjedhjet pararendëse, një faktor i rëndësishëm në rritjen e transparencës së veprimtarisë së KQZ-së, ishte publikimi i rezultatit paraprak dhe atij përfundimtar. Të gjitha mediave, si dhe çdo qytetari të interesuar, iu dha akses direkt nga ekranet e KQZ-së, brenda dhe jashtë ambienteve të saj. Kjo infrastrukturë transparente, nëpërmjet medias, i erdhi në

ndihmë të gjithë opinionit publik, pasi ishte vet media që në transmetimin e rezultateve i referoheshin të dhënave zyrtare të pasqyruara nga KQZ.

Në zgjedhjet vendore të 25 Qershorit 2017, në faqen zyrtare të KQZ-së, rubrika e Raporteve të BMM, ku çdo ditë hidheshin raportet e monitorimit të televizioneve përsa i përket transmetimit të fushatës, bëri të mundur informimin në kohë të çdo operatori lidhur me ecurinë e tij gjatë monitorimit.

Çdo informacion i cili përbën interes për publikun dhe median është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, duke i ofruar aksesin e nevojshëm të gjithë të interesuarve.

Për periudhën 07-25 qershor 2017, KQZ realizoi fushatën edukuese dhe informuese për zgjedhësit në zbatim të strategjisë së edukimit zgjedhor të miratuar nga Komisioni. Për zgjedhjet parlamentare 2017 u përgatiten 6 spote televizive (4 KQZ, 1 spot KQZ/UN Woman, 1 spot KQZ/OSBE) dhe 2 spote radiofonike, si edhe 8 modele posterash.

Fushata edukuese e KQZ-së u pasqyrua në 26 media. Spotet televizive u transmetuan 816 herë për 19 ditë në 11 televizione me shtrirje sinjali në të gjithë territorin e Shqipërisë. Spotet u transmetuan 24 orë në faqen e parë të 3 web-siteve më të klikuara nga shqiptarët brenda dhe jashtë vendit. Spotet radiofonike u transmetuan 592 herë për 19 ditë në 3 radio me shtrirje sinjali në të gjithë vendin. 8 posterat e KQZ-së u publikuan 126 herë për 19 ditë në 9 gazeta të formatit të printuar.

Gjatë zgjedhjeve, veprimtaria e KQZ-së u ndoq nga 17 televizione, nga të cilat 5 televizione informative, 18 gazeta të printuara dhe rreth 560 portale online. KQZ është ndjekur edhe nga 9 media, të cilat qendrën redaksionale e kanë jashtë Shqipërisë; BIRN, Reuters, Associated Press, Al Jazeera, Anadolu Agency, RTK Kosova, Radio Kosova, Gazeta Illyria, dhe Kosova Press. Për zgjedhjet për Kuvendin u akredituan edhe 2 media të huaja, Financial Times dhe ORF e Austrisë.

II. 4 Fleta e Votimit

KQZ duke vlerësuar integritetin e fletës së votimit, si një nga elementët që ndikon drejtpërsëdrejti në standartet e procesit zgjedhor, në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor i kushtoi rëndësi të veçantë përcaktimit të specifikimeve të fletës së votimit, procesit të përgatitjes së fletëve të votimit, integritetit të prodhimit dhe më tej, shpërndarjes së tyre.

KQZ, në përmbushje të detyrave të veta, me vendimin nr. 339, datë 30.05.2017, miratoi modelin dhe specifikimet teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvend 2017. Në bazë të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, në këto specifikime u përfshinë veç të tjerash dhe shënimi i numrit të qendrës së votimit e i Zonës së Administrimit Zgjedhor përkatës. Gjithashtu, fleta e votimit kishte elemente identifikuese të cilat nuk lexoheshin me sy të lirë në formën e barkodeve.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, KQZ pati parasysh eksperiencat e zgjedhjeve të mëparshme për sa i përket numrit të subjekteve zgjedhore të regjistruara në fletën e votimit. Në përfundim të procesit të regjistrimit të listave shumëmemërore nga partitë politike, rezultoi se numri i tyre ishte 18 subjekte.

II. 5 Përgatitja e materialeve zgjedhore dhe dokumentacionit zdhejdhor nga KQZ në KZAZ dhe nga KZAZ në KQV

Logjistika Zgjedhore funksionon mbi bazën e një sistemi të centralizuar të organizimit, përgatitjes, transportit dhe mbledhjes së dokumentacionit dhe materialeve zgjedhore. Si e tillë, ajo mund të mbështetet vetëm në burime dhe institucione që kanë mundësi të garantojnë një infrastrukturë të tillë, siç është Ministria e Mbrojtjes. Përgjithësisht, ky proces zgjedhor nuk ka patur problematikë të ngritur apo qoftë edhe të pretenduar për sa i përket materialeve zgjedhore. Materialet zgjedhore u siguruan dhe përgatitën brenda afateve ligjore që parashikon Kodi Zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bazë të urdhërimeve dhe afateve kohore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, nëpërmjet gjithë Administratës realizoi me sukses shpërndarjen e materialeve zgjedhore dhe fletët e votimit në 90 Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Duhet theksuar se respektimi i këtij afati erdhi si rezultat i planifikimit në kohën e duhur të infrastrukturës së logjistikës zgjedhore dhe të bazuar në një sistem të organizuar dhe jo rastësor, duke garantuar një standart të përmirësuar të përgatitjes dhe administrimit të logjistikës zgjedhore, si dhe dërgimi i saj në destinacionin e duhur (pranë çdo KZAZ), brenda afatit kohor të parashikuar në Kodin Zgjedhor.

Çdo Komision Zonal i Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV) ka patur në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe materialet zgjedhore të domosdoshme për zbatimin e procedurave dhe përmbushjes së detyrave që Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, iu ngarkon këtyre komisioneve. Komisionet Zonale të administrimit Zgjedhor (KZAZ), Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) dhe Kryetarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit, u pajisën me vulat sipas modeleve të miratuara nga KQZ dhe të prodhuara në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme. Vulat dhe materialet e tjera zgjedhore u dorëzuan me procesverbalet respektive, sipas modeleve të miratuara nga KQZ. Element që duhet vënë në zbatim mbetet "Paketa" e programit për logjistikën, i cili parashikon identifikimin me anë të bar-codes të paketës së materialeve zgjedhore nga KQZ-KZAZ-KQV dhe anasjelltas. Kjo paketë nuk u aplikua dhe lëvizja e materialeve zgjedhore u bazua thjesht në sistemin e vërtetimit me anë të procesverbaleve të miratuara nga KQZ.

II.6 Dita e Zgjedhjeve

Anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit u paraqiten në qendrën e votimit në ora 6:00, një orë para hapjes së votimit, përmbushën detyrat dhe procedurat paraprake për organizimin e qendrës së votimit, heqjen e materialeve propogandistike në një rreze 150 m nga qendra e votimit, afishimin e posterave të dërguar nga KQZ, mbylljen e kutisë së votimit dhe plotësimin e procesverbalit përkatës, dhe marrjen e vendimit për fillimin e votimit. Në të 5 362 QV, votimi u hap në ora 7:00, dhe procesi i votimit u zhvillua qetësisht. Nuk pati asnjë rast të braktisjes së detyrës nga komisionerët e qendrave të votimit apo pezullim të votimit për më shumë se 6 orë, i cili do të çonte në pavlefshmëri të zgjedhjeve.

Numri i problematikave ishte i vogël dhe me natyrë teknike. Më konkretisht, sipas tipologjive:

Për materiale zgjedhore

- Në një qendër votimi të Bashkisë Lezhë, kutia e votimit ishte dëmtuar gjatë transportit, dhe u zëvendësua me kuti votimi përpara përpara hapjes së votimit në ora 7:00;
- Në tre qendra votimi, një në Bashkinë Korçë, një në Bashkinë Lezhë dhe një në Bashkinë Finiq, komisionerët kutinë e votimit e kishin mbyllur me kapakun që i përkiste kutisë së materialeve zgjedhore. KZAZ-të respektive, së bashku me Inspektorët Rajonalë, morrën masat dhe brenda një kohe shumë të shkurtër zgjidhën problematikat duke respektuar procedurat ligjore.

Për fletët e votimit

- Më datë 24 qershor 2017, ora 22:00, KQZ-ja vendosi të autorizojë KZAZ nr. 27, Qarku Tiranë, të pajisë qendrën e votimit nr. 1595/1 me 631 fletë votimi, të cilat u verifikuan që ishin dëmtuar, duke marrë fletë votimi nga 30 qendra votimi në juridiksion të kësaj KZAZ-je, të përcaktuara në vendimin e KQZ-së. Fletët e votimit u dërguan në qendrën e votimit nr. 1595/1 përpara hapjes së saj.
- Më datë 25 qershor, ora 10:00, KQZ vendosi të pajisë me 112 flete votimi shtesë qendrën e posaçme të votimit nr. 0748/1, KZAZ nr. 13, Qarku Lezhë.

Dëmtim/humbje të vulës

KQZ disponoi me vendim 5 pesë raste të zëvendësimit të vulave për shkak të dëmtimit apo humbjes së tyre, një rast i njoftuar një ditë para ditës së zgjedhjeve dhe katër raste ditën e zgjedhjeve. Ndryshe nga ato të vitit 2013, në këto zgjedhje nuk u njoftua asnjë rast për tejmbushje të kutisë së votimit me fletë votimi, kjo për shkak të përmasave shumë më të vogla të fletës së votimit krahasuar me përmasat e fletës së votimit të vitit 2013.

Nuk u referua asnjë rast për zgjedhës që të kishin probleme me gjetjen e qendrës së tyre të votimit, apo që nuk i figuronte emri në listën e zgjedhësve. Nga 72 qendra votimi ose 1.2% e 5 362 qendrave të votimit, u kërkua ndërhyrja e punonjësit të Policisë së Shtetit për të rivendosur regullin dhe qetësinë në to.

KQZ-ja, duke vlerësuar se pjesëmarrja e zgjedhësve në votim deri në orën 18:00 ishte e ulët, dhe kjo mund të vinte për arsye objektive, si temperaturat e larta, besimtarët myslimanë përfundonin ritet e festës zyrtare të "Fiter Bajrami", në orët e pasdites, urdhëroi të gjitha Komisionet e Qendrave të Votimit të shtynin orarin e votimit deri në orën 20.00.

KQZ ditën e votimit informoi opinionin publik për pjesëmarrjen në zgjedhje në orën 10:36, ora 13:15, ora 16:05, dhe në orën 21:05. Informacioni u dha në shifër absolute dhe në përqindje, në rang zone administrimi zgjedhore, bashkie, qarku dhe rang vendi.

Të dhënat e pasqyruara në tabelën më poshtë referojnë të dhënat zyrtare të marra nga dokumentacioni shkresor i komisioneve të qendrave të votimit. Për 302 qendra votimi, të shpërndara në 12 qarqe, komisionet përkatëse nuk kishin evidentuar në dokumentacion numrin e votueseve gra. Në rang vendi, në zgjedhjet për Kuvendin 2017 kanë votuar 714.961 femra, ose 41,85 % e femrave të regjistruara në listën e zgjedhësve. Pjesëmarrja e femrave në votim shënoi nivelin më të lartë në Qarkun Kukës dhe Diber, dhe nivelin më të ulët në Qarkun Vlorë.

Nr	Qarku	Zgjedhësit			Pjesëmarrja					
		Totali	Femra	Meshkuj	Totali		Femra		Meshkuj	
			nr.	nr.	nr.	%	nr.	%	nr.	%
1	Berat	180.682	87.990	92.692	85.379	47,25%	38.844	44,15%	46.007	49,63%
2	Diber	131.313	63.644	67.669	73.702	56,13%	34.029	53,47%	35.948	53,12%
3	Durres	337.114	167.357	169.757	150.554	44,66%	60.560	36,19%	69.467	40,92%
4	Elbasan	336.969	164.625	172.344	166.551	49,43%	71.005	43,13%	77.661	45,06%
5	Fier	392.299	190.446	201.853	185.523	47,29%	79.973	41,99%	95.687	47,40%
6	Gjirokaster	123.831	61.273	62.558	55.337	44,69%	24.915	40,66%	29.390	46,98%
7	Korçe	280.473	139.869	140.604	132.463	47,23%	61.673	44,09%	67.897	48,29%
8	Kukes	81.108	40.059	41.049	42.836	52,81%	20.160	50,33%	21.839	53,20%
9	Lezhe	167.756	82.642	85.114	74.568	44,45%	32.954	39,88%	36.963	43,43%
10	Shkoder	263.728	130.316	133.412	112.404	42,62%	47.640	36,56%	57.258	42,92%
11	Tirane	849.021	427.611	421.410	423.732	49,91%	193.456	45,24%	212.594	50,45%
12	Vlore	308.030	152.731	155.299	110.761	35,96%	49.752	32,57%	58.957	37,96%
Total ne rang vendi		3.452.324	1.708.563	1.743.761	1.613.810	46,75%	714.961	41,85%	809.668	46,43%

II.7 Dorëzimi i materialit zgjedhor në KZAZ-të pas mbylljes së QV-së

Në ora 24:00, të datës 25 qershor 2017, në të gjitha Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor kishte përfunduar dorëzimi i kutive të votimit dhe kutive të materiale zgjedhore në respektim të procedurave dhe afatit ligjor. Gjatë këtij procesi, vetëm 4 kuti u vlerësuan të parregullta (dy kuti votimi dhe dy kuti të materialeve të votimit) ose 0.03 % e 10 472 kutive të dorëzuara (5362 kuti votimi dhe 5362 kuti të materialeve të votimit).

II.8 Procesi i numërimit në VNV, tabulimi dhe nxjerrja e rezultatit nga KZAZ

Numërimi nuk filloi në të gjitha KZAZ-të menjëherë pas përfundimit të procesit të dorëzimit të materialeve zgjedhore. Shkaku i vonës kishte të bënte me emërimet edhe në minutë të fundit të numëruesve dhe trajnimin e tyre. Në orën 3:00 të datës 26.06.2017, numërimi kishte filluar dhe po vijonte me ritme të kënaqshme në të gjithë KZAZ-të.

Më datën 26.06.2017, ora 20.30, kishte përfunduar procesi i numërimit në 45 nga 90 KZAZ. Në ora 22:00 të datës 26.06.2017, në rang vendi ishin numëruar 4 264 kuti votimi nga 5 362 në total. Kryetari i KQZ-së, në përfundim të afatit ligjor për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve nga KZAZ, përmes një deklarate publike në media adresoi një apel të fortë për KZAZ-të që nuk kishin përmbushur ende këtë detyrim ligjor.

Pavarësisht se mbetet për tu numëruar një numër relativisht i vogël i kutive të votimit, 1098 ose 20% e totalit, numërimit I tyre zgjati edhe 23 orë, kryesisht për shkak të lodhjes së komisionerëve dhe numëruesve.

Transparenca përgjatë procesit të numërimit të votave dhe tabulimit të rezultatit nga GNV/KZAZ ishte e plotë. Sstemi i kamerave dhe monitorëve të instaluar nga KQZ në çdo tavolinë të numërimit të votave funksionoi në mënyrë efikase. Transmetimi në serverat e KQZ-së të tabulës së rezultateve të çdo qendre votimi, u krye në respekt të procedurës së miratuar nga KQZ-ja.

KQZ -ja evidentoi në dy raste tendenca të KZAZ-ve për të vepruar në kundërshtim me ligjin. Kutitë votimi të marra në dorëzim të rregullta, të deklaroheshin të parregullta gjatë procesit të numërimit. Përmes vendimarrjeve u urdhëruan KZAZ nr. 64, Qarku Berat, dhe KZAZ nr. 11,

Qarku Kukës, të përmbushnin procedurat në mënyrë korrekte, të kryenin numërimin e fletëve të votimit të çdo kutie votimi që ishte marrë në dorëzim e rregullt.

Procesi i numërimit të votave përfundoi më datë 27.06.2017, ora 19:00 dhe si në asnjë proces zgjedhor tjetër vetëm dy ditë pas datës së zgjedhjeve. Në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013 procesi i numërimit të votave u mbyll brenda shtatë ditëve pas ditës së zgjedhjeve, në zgjedhjet vendore 2015 u mbyll brenda gjashtë ditëve pas ditës së zgjedhjeve dhe në zgjedhjet vendore 2011 brenda 14 ditëve pas ditës së zgjedhjeve.

II.9 Publikimi i rezultatit paraprak, nxjerrja e rezultatit nga KQZ, rezultati përfundimtar.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave dhe plotësimit të tabelave të rezultateve të çdo qendre votimi nga grupet e numërimit të votave për çdo zonë zgjedhore, KQZ-ja verifikoi tabelat e rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ për çdo zonë zgjedhore përkatëse dhe miratoi me vendim tabelat përmbledhëse të rezultatit për çdo zonë zgjedhore, mbështetur në origjinalet e tabelave të çdo qendre votimi sipas zonave zgjedhore, të plotësuara nga grupet e numërimit të votave.

Në përfundim të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve ligjore të ankimit në KQZ dhe në Kolegjin Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbi bazën e rezultatit të votimit për çdo zonë zgjedhore, përllogariti shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore si dhe kandidatët fitues për çdo parti politike.

Pas shpalljes së rezultatit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore si dhe në përfundim të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve ligjore të ankimit në Kolegjin Zgjedhor, KQZ shpalli me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve, i shpallur nga KQZ, përfshinte numrin e votave, numrin e mandateve dhe listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt në çdo zonë zgjedhore si dhe numrin e votave, numrin e mandateve dhe listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt zgjedhor në shkallë vendi.

II.10 Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Kodit Penal

- a. Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Kodit Penal nga komisionerët niveleve të dyta

KQZ gjatë shqyrtimit të kërkesave ankimore, në përputhje me nenin 136 dhe 138 të Kodit Zgjedhor administroi me cilësinë e provës dokumentacionin zgjedhor të përpunuar nga komisionet zgjedhore përkatëse, dhe vendosi të rinumërojë dhe rivlerësojë votat për 68 qendra votimi në Zonën Zgjedhore Qarku Tiranë, sipas objektit të ankimit.

Nga procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në KQZ, gjithsej për 68 qendra votimi rezultoi se:

- për 9 prej tyre rezultati i dalë nga rinumërimi ishte në përputhje të plotë me rezultatin e nxjerr sipas nenit 119 të Kodit Zgjedhor nga Grupet e numërimit;

- për 35 qendra votimi rezultati i votimit ndryshoi pas rivlerësimit të votave;
- për 24 qendra votimi rezultati i dal nga rinumërimi ishte i ndryshëm me rezultatin e nxjerr sipas nenit 119 të Kodit Zgjedhor nga Grupet e Numërimit.

Për sa i përket rasteve të klasifikuara në germën c më lartë gjatë procesit të rinumërimit rezultoi se anëtarët e grupeve të numërimit që kanë numëruar votat për këto qendra, kanë shënuar në tabelën e rezultatit të grupit të numërimit numër më të vogël votash për disa subjekte dhe numër më të madh votash për disa subjekte të tjera, krahasuar me numrin real të votave që u gjendën në kutinë e votimit, gjatë procesit të rinumërimit në KQZ. Në këtë mënyrë rezultati i qendrës së votimit nuk pasqyron rezultatin real të cilët zgjedhësit e këtyre qendrave kanë shprehur nëpërmjet votimit, duke favorizuar disa subjekte zgjedhore. Ndryshimet e konstatuara në tabelat e rezultatit ishin në një masë të tillë që nuk sollën pasoja në rezultat apo në pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonë zgjedhore.

Në këto kushte anëtarët e Grupeve të Numërimit në KZAZ nr. 26, KZAZ nr.27, KZAZ nr.30, KZAZ nr.32, KZAZ nr.33, KZAZ nr.34, KZAZ nr.35, KZAZ nr.36, KZAZ nr.38, KZAZ nr.39, KZAZ nr.43, për 24 qendrat e votimit të sipërpërmendura kanë konsumuar elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 326, paragrafi i parë i Kodi Penal për Falsifikimin e materialit zgjedhor dhe rezultatit të zgjedhjeve.

KQZ, me vendimin nr.550 datë 19.07.2017 vendosi të bëjë kallëzim penal ndaj shtetasve me detyrë anëtarë, dhe numëruar i parë grupeve të numërimit të KZAZ nr. 26, KZAZ nr.27, KZAZ nr.30, KZAZ nr.32, KZAZ nr.33, KZAZ nr.34, KZAZ nr.35, KZAZ nr.36, KZAZ nr.38, KZAZ nr.39, KZAZ nr.43, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Deri në këto momente nuk ka asnjë vendimmarrje nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Jemi në pritje të vendimmarrjes nga ana e institucioneve të sipërpërmendura.

b. Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga subjektet zgjedhore

Në procesin e verifikimit të listave shumemërore të kandidatëve për deputet për Kuvend, u konstatuan se 3 (tre) parti politike nuk kishin respektuar kriterin e gjinisë, përkatësisht: Partia Demokratike në 12 (dymbëdhjetë) zona zgjedhore, Partia Socialiste në 1 (një) zonë zgjedhore, dhe Lëvizja Socialiste për Integrim në 1(një) zonë zgjedhore. Megjithë evidentimin dhe njoftimit për mos zbatim të kriterit gjinor, nga këto subjekte zgjedhore nuk u shfrytëzua e drejta e plotësimit/korrigjimit të listave shumemërore sipas përcaktimeve dhe afateve të Kodit Zgjedhor. KQZ, në mbështetje të nenit 67, 175 të Kodit Zgjedhor për subjektet zgjedhore të sipërpërmendura të cilat nuk respektuan kriterin gjinor vendosi sanksione administrative përkatësisht në vlerën 12 milion lekë për Partinë Demokratike, 1 milion lekë për Partinë Socialiste dhe Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim.

II.11 Ankimet dhe statusi i tyre

Ankimet në KQZ

Për zgjedhjet për Kuvendin 2017, përpara datës së zgjedhjeve nuk është depozituar në KQZ asnjë kërkesë ankimore nga subjektet zgjedhore. Pas datës së zgjedhjeve në KQZ u depozituan

gjithsej 3 kërkesa ankimore, kundër vendimeve të KQZ për nxjerrjen e rezultatit përkatësisht për zonën zgjedhore, Berat, dhe Tiranë. KQZ për të tre kërkesat ankimore vendosi shqyrtimin në themel. Në çdo rast, kur kërkesa ankimore kishte indicie të mjaftueshme nga provat e paraqitura, fakte dhe argumente bindëse, KQZ-ja ka thelluar hetimin administrativ, duke këqyrrur të gjithë dokumentacionin zgjedhor apo dhe materialin zgjedhor të ndodhur në kutinë e materialeve zgjedhore dhe kutitë e votimit me fletët e votimit.

Në KQZ, pas datës së zgjedhjeve u depozituan gjithësej 3 kërkesa ankimore, kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore përkatësisht qarku Berat dhe qarku Tiranë, nga subjektet zgjedhore si më poshtë.

- Partia Demokratike e Shqipërisë;
- Partia Socialiste e Shqipërisë;
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

Partia Lista e Barabartë, depozitoi me datë 25 qershor një kërkesë ankimore kundër vendimit të KZAZ-së nr.4 për akreditimin e vëzhguesve të subjektit zgjedhor Libra.

Për 3 kërkesat ankimore KQZ vendosi pranimin e ankimit dhe ndryshimin e vendimit përkatës të KQZ-së.

Për 1 kërkesë ankimore u vendos pushimi i çështjes, pasi ankuesi (Partia Lista e Barabartë) hoqi dorë nga objekti i ankimit.

Ankimet në Kolegjin Zgjedhor

Në periudhën para datës së zgjedhjeve u paraqitën në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë, gjithsej 6 kërkesa ankimore.

ANKIME PARAZGJEDHORE TË PARAQITURA NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE NË KOLEGJIN ZGJEDHOR:

Në Kolegjin Zgjedhor për Zgjedhjet e Kuvendit 2017, para datës së zgjedhjeve u depozituan gjithsej 5 kërkesa ankimore kundër vendimit të KQZ-së nga partitë politike si më poshtë:

- Partia Lista e Barabartë;
- Partia Agrare Ambjentaliste;
- Partia Aleanca Popullore;
- Partia Forca Rinia;
- Partia Lëvizja Socialiste Për Integrim.

Një kërkesë ankimore u depozitua nga një individ të cilit ju refuzua kërkesa për regjistrimin si kandidat i mbështetur nga zgjedhësit.

KËRKESAT ANKIMORE SIPAS OBJEKTIT:

- Partia Politike "Lista e Barabartë" ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: *Detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim ndaj çështjes së ngritur nga Partia Politike "Lista e Barabartë", me germa nistore "LIBRA" me kërkesën e datës 31.01.2017 për konstatimin prej KQZ-së të vërtetimit të plotësimit të kushtit parashikuar prej pikës 3 të nenit 68 të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"(i ndryshuar), për zotërimin e mandatit të paktën 6 muajt e fundit". Kolegji Zgjedhor vendosi pranimin i ankimit.*

- Partia Agrare Ambientaliste ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: *Kundërshtimi i vendimeve të KQZ-së nr. 283, 284, 285, 286, 287, 288 datë 05.05.2017 dhe nr.289, 290, 291, 292, 293, 294, 295, 296, 297 datë 07.05.2017 dhe gjykimi i çështjes në themel duke vendosur çregjistrimin e listave shumemërore të kandidatëve për deputetë, si të depozituara jashtë afatit të përcaktuar në nenin 67 të Kodit Zgjedhor. Kolegji Zgjedhor vendosi pushimin i gjykimit.*
- Partia Aleanca Popullore ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: *Gjykimi i Çështjes në themel duke vendosur çregjistrimin e listave shumemërore të kandidatëve për deputetë, si të depozituara jashtë afatit të përcaktuar në nenin 67 të Kodit Zgjedhor. Kolegji Zgjedhor vendosi pushimin e gjykimit.*
- Partia Forca Rinia ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: *Kundërshtimi i vendimeve nr. 335, datë 28.05.2017 dhe nr. 338, datë 30.05.2017. Kolegji Zgjedhor vendosi rrëzimin e kërkesë-padisë.*
- Zoti D. C. ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt *Kundërshtimi i vendimit nr.327, datë 28.05.2017 "Për mos regjistrimin e z. D.C. si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në Zonën Zgjedhore të qarkut Tiranë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 qershor 2017. Kolegji Zgjedhor vendosi rrëzimin e kërkesë padisë*
- Partia Lëvizja Socialiste Për Integrim ka paraqitur 1 ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: *Kundërshtimi i Vendimit Nr.386, datë 12.06.2017, të KQZ-së "Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 qershor 2017. Kolegji Zgjedhor vendosi pranimin e kërkesë padisë.*

Në mbështetje të nenit 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor, përpara datës së zgjedhjeve, KQZ cakton me vendim parti të politike të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave (GNV). Për zgjedhjet për Kuvendin 2017, KQZ, me vendimin nr. 386, datë 12.06.2017, caktoi Partinë Socialiste për Integrim dhe Partinë Drejtësi, Integrim dhe Unitet si parti të cilat do të caktojnë anëtarin e tretë të GNV-ve sipas rezultatit të shortit, si edhe Partinë Republikane, si parti e cila ka të drejtë të caktojë anëtarin e katërt të GNV-ve. Në arsyetimin e vendimit të mësipërm, KQZ iu referua praktikës së Kolegjit Zgjedhor të vendosur në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015, sipas të cilit kriteri për përcaktimin e "partive të shumicës parlamentare" dhe "partive të opozitës parlamentare" është pozicionimi faktik i partisë politike në momentin kur KQZ merr vendimin.

Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ushtroi të drejtën e ankimit kundër vendimit të KQZ-së nr. 386, datë 12.06.2017, në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 9, datë 20.06.2017, vendosi pranimin e kërkesëpadisë dhe përcaktoi Partinë Socialiste për Integrim si parti të shumicës parlamentare që ka të drejtë të caktojë anëtarin e tretë të GNV-ve; dhe Partinë Republikane e Partinë Drejtësi Integrim dhe Unitet si parti të opozitës, që do të caktojnë anëtarin e katërt të GNV-ve, sipas rezultatit të shortit. Sipas arsyetimit të Kolegjit Zgjedhor në vendimin e sipërcituar, kriteri për përcaktimin e "partive të shumicës parlamentare" dhe "partive të opozitës parlamentare" është rezultati i zgjedhjeve paraardhëse dhe klasifikimi i partive sipas rezultatit në parti të shumicës parlamentare dhe parti të opozitës parlamentare.

Vendimet e KQZ-së për përcaktimin e partive të cilat do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve (që prej zgjedhjeve të vitit 2009) kanë qenë rregullisht objekt ankimi në Kolegjin Zgjedhor. Konkretisht:

- Në zgjedhjet për Kuvendin 2009, KQZ caktoi partitë politike të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve me vendimin nr. 173, datë 21.05.2009, duke arsyetur së në përcaktimin e "partive të shumicës parlamentare" dhe "partive të opozitës parlamentare" kriter duhet të jetë pozicionimi faktik i partive politike në momentin kur KQZ merr vendimin. Kolegji Zgjedhor shfuqizoi vendimin e KQZ dhe, me vendimin nr.5, datë 6.06.2009 arsyetoi se kriteri për përcaktimin e "partive të shumicës parlamentare" dhe "partive të opozitës parlamentare" është rezultati i zgjedhjeve paraardhëse.

- Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2015, KQZ caktoi partitë politike të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve me vendimin nr. 611, datë 02.06.2015. Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 19, datë 8.6.2015, arsyetoi se kriteri për përcaktimin e "partive të shumicës parlamentare" dhe "partive të opozitës parlamentare" është pozicionimi faktik i partisë politike në momentin kur KQZ merr vendimin dhe jo rezultati i zgjedhjeve paraardhëse.

Pas përfundimit të procesit të votimit dhe miratimit të rezultatit të votimit për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve të zonave të administrimit zgjedhor dhe Tabelave të Rezultatit të qendrave të votimit të plotësuara nga grupet e numërimit, asnjë prej vendimeve të KQZ-së për zgjedhjet për Kuvendin 2017 nuk u ankimua nga subjektet zgjedhore në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

• ANKIME TË PARAQITURA NË KOLEGJIN ZGJEDHOR NË LIDHJE ME SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 566, datë 05.10.2017 "Për vendosjen e sanksionit administrativ për barazinë gjinore në listat shumëmemërore të kandidatëve për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.06.2017" vendosi sanksion administrative ndaj Partisë Demokratike, në masën 12.000.000 lekë për shkak të mospërmbushjes e kriterit të gjinisë në listat shumëmemërore të kandidatëve për deputet të këtij subjekti.

Partia Demokratike depozitoi ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt: *Kundërshtimi i vendimit 566, datë 05.10.2017 "Për vendosjen e sanksionit administrativ për barazinë gjinore në listat shumëmemërore të kandidatëve për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.06.2017", Kolegji Zgjedhor me vendimin nr.----, datë ka vendosur; Rrëzimi i Kërkesë Padisë dhe lënien në fuqi të vendimit të KQZ-së.*

• ANKIME NË LIDHJE ME VENDIMARRJEN E KQZ-SË NË ZBATIM TË LIGJIT 138/2015 "PËR GARANTIMIN E PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet përkatëse ka vendosur për 11 anëtarë të këshillave Bashkiak të shpall të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit. Tre prej tyre kundër vendimit të KQZ-së, për shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit, kanë bërë ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë për 2 kërkesa ankimore, vendosi rrëzimi i kërkesë padisë, për 1 kërkesë ankimore vendosi pranimi i kërkesë padisë dhe ndryshimin e vendimit të KQZ-së. Çështjet janë në gjykim pranë Gjykatës Administrative të së Apelit Tiranë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.174 dt.29.12.2016 vendosi, të shpall të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Kavajë z. Elvis Roshi.

Kundër vendimit të sipërcituar, z. Elvis Roshi ka bërë ankim në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 24 datë 23.03.2017, ka vendosur rrëzimin e Kërkesë Padisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjatë vitit 2016 me vendimet përkatëse ka vendosur për dy ish deputet në Kuvendin e Shqipërisë të shpall të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit. Kundër vendimeve të KQZ-së subjektet kanë bërë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë për të dy rastet ka vendosur, rrëzimin e kërkesë padisë. Çështjet janë në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PJESA III – PERIUDHA PASZGJEDHORE

III.1 Financimi i subjekteve zgjedhore

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbështetje të nenit 21, pika 15, nenit 91 të Kodit Zgjedhor, nenit 15/2, pika 1 i ligjit nr.8580 datë 17.02.2000 "Për partitë politike", ndryshuar me ligjin nr. 90/2017, datë 22.05.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580 "Për partitë politike", është organi përgjegjës për kontrollin, monitorimin dhe mbikqyrjen e financimit të fushatës zgjedhore të partive politike, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ligjet e sipërcituara.

Në zbatim të kompetencave ligjore dhe referuar nenit 24/4, të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike" i ndryshuar me ligjin nr.90/2017 " Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, " Për partitë politike" të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.374, datë 09.06.2017 "Shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiar, të cilët do të kryejnë monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017", emëroi me short 24 ekspertë financiar, për të kryer monitorimin e fushatës zgjedhore të partive politike, duke përfshirë aktivitetet, veprimtarinë dhe materialet e përdorura prej tyre gjatë fushatës zgjedhore.

Referuar nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor, për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike të regjistruara si subjekt zgjedhor, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 qershor 2017, KQZ me vendimin nr.559, datë 31.07.2017 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin 2017", emëroi me short 15 ekspertë kontabël të licencuar për auditimin e partive politike të regjistruara si subjekt zgjedhor.

Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike" i ndryshuar me ligjin nr.90/2017, datë 22.05.2017, në nenin 24/3 të tij, parashikoi për herë të parë detyrimin e partive politike për të

depozituar në KQZ, brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve raportin për deklarinimin financiar të fushatës, duke përfshirë të gjitha degët dhe pjesët e veta përbërëse.

Raporti duhet të përmbajë në mënyrë të saktë:

- a) të ardhurat e përfituara apo që ka në gjendje partia politike, duke përfshirë burimin dhe datën e përfitimit, për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve;
- b) të gjitha shpenzimet e kryera për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve, duke detajuar çdo shpenzim që i është bërë fondit financiar të dhënë për shpenzimet e fushatës zgjedhore;
- c) bilancin e pasurive dhe detyrimeve që ka partia politike, për periudhën nga data e caktimit të datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

KQZ me vendimin nr.167, datë 21.04.2017, "Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të standartizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore" miratoi formatin e standartizuar dhe udhëzuesin përkatës për mënyrën e raportimit financiar nga Partitë Politike.

Referuar nenit 24/3 të ligjit 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" i ndryshuar, data 25 shtator ishte afati i fundit i depozitimit të raportit financiar të partive politike. Në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017 morën pjesë 18 parti politike.

- 16 parti politike kanë dorëzuar raportin financiar në KQZ, nga të cilat 8 parti e kanë dorëzuar brenda datës 25 shtator 2017 dhe 8 parti politike e kanë dorëzuar jashtë afatit ligjor.
- 2 parti politike Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet dhe Partia Sfida për Shqipërinë nuk kanë dorëzuar raportin financiar në KQZ.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka publikuar raportet e financiare për fushatën zgjedhore në faqen zyrtare të internetit sipas moduleve elektronike të mirëstrukturuara. Gjithashtu KQZ nëpërmjet një deklaratë publike bëri thirrje çdo subjekti të interesuar që mund të disponojë informacion për:

- Të ardhurat e përfituara apo që ka në gjendje partia politike për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve, të padeklaruara;
- Të gjitha shpenzimet e kryera për periudhën duke përfshirë burimin dhe datën e përfitimit, për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve, të padeklaruara;
- Depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera gjatë periudhës së monitorimit, të padeklaruara, duhet ti paraqesë ato në KQZ, së bashku me provat dhe faktet që mbështesin peretendimet e paraqitura.

Pranë KQZ asnjë subjekt zgjedhor apo përfaqësues i shoqërisë civile, nuk paraqiti ankesa apo pretendime në lidhje me të dhënat e deklaruara në raportet financiare të partive politike.

Ekspertët kontabël të licensuar, referuar afateve të auditimit të përcaktuar në kontratat e lidhura me KQZ, depozituan raportet e auditimit për fondet e përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore 2017 për 18 partitë politike, më poshtë raporti i auditimit.

Ekspertët financiar gjatë zhvillimit të fushatës përpara datës së zgjedhjeve kanë depozituar në KQZ dy raporte të ndërmjetme dhe referuar afatit të përcaktuar 24/4, pika 2 të të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike" i ndryshuar me ligjin nr.90/2017, kanë depozituar

në KQZ raportet e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017, më poshtë raporti i monitorimit.

Ekspertët kontabël në raportet e auditimit shprehin opinionin e tyre në lidhje me respektimin e rregullave dhe ndalimeve të parashikuara nga neni 87/1, neni 89, neni 90 dhe neni 91, pika 2 dhe 3 i Kodit Zgjedhor për fondet e përfituara dhe të shpënuara nga Partia Politike gjatë fushatës zgjedhore.

Ekspertët financiar në raportet e monitorimit shprehin opinionin e tyre në lidhje me:

- a) zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017;
- b) Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor;
- c) Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive;
- d) kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruara nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit;
- e) Rregullat e brendshme të subjektit elektoral për raportimin e shpenzimeve;
- f) Transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike.

KQZ administroi raportet e auditimit dhe raportet e monitorimit dhe shqyrtoi konkluzionet e tyre në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore nga partitë politike në lidhje me financimin. Gjithashtu mbi bazën e opinioneve të shprehura nga ekspertët kontabël në këto raporte, krahasoi të ardhurat e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga partitë politike sipas raporteve me të ardhurat e përfituara dhe shpenzimet e kryera të deklaruara nga partitë politike.

Në përfundim të procesit të verifikimit, KQZ vendosi 7 sanksione administrative me gjobë për 7 parti politike pjesmarrëse në zgjedhjet e datës 25 qershor 2017, përkatësisht: Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 2 milionë lekë, Partia SFIDA 2 milionë lekë, Partia Socialiste 1 milionë, Partia Demokratike 1 milionë, Lëvizja Socialiste për Integrim 1 milionë, Partia Socialdemokrate 1 milionë, Partia Aleanca Demokristiane 1 milionë.

III.2 Analiza vjetore e punës

KQZ me mbështetjen e Prezencës së OSCE dhe UN Women, si praktikë pune tashmë e konsoliduar zhvilloi analizën vjetore të punës në datat 13-14 Dhjetor 2017. Fokusi kryesor ishte puna për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve për Kuvendin të datës 25 Qershor 2017. Temat e trajtuara nga niveli drejtues i administratës së KQZ-së, diskutimet rreth tyre, dhanë një panoramë të përmbledhur dhe të plotë të punës institucionale për përgatitjen, organizimin, zhvillimin dhe shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin 2017. Raporti Përfundimtar i OSCE/ODHIR, por edhe raportet e organizmave të tjerë ndërkombëtarë dhe vendas që monitoruan procesin zgjedhor të 25 qershorit 2017, ishin bazë referuese në trajtimin e temave, diskutimet për problemet e evidentuara, gjetjet dhe rekomandimet në funksion të rritjes së standarteve të procesit zgjedhor.

Gjetjet dhe përfundimet e Analizës së Punës, sipas natyrës së tyre klasifikohen në tre kategori: (1) mundësi për përmirësime të Kodit Zgjedhor, (2) zhvillimi i qëndrueshëm institucional, (3) përmirësime infrastrukturore, logjistike, organizative. Të kategorisë së II-të e të III-të, do të orientojnë veprimtarinë institucionale në të ardhmen, veçanërisht punën në vit zgjedhor. Sa I përket mundësive për përmirësime të Kodit Zgjedhor, gjetjet e analizës së punës 2017 plotësojnë rekomandimet që KQZ ka dërguar në Kuvendin e Shqipërisë në vitin 2014 dhe në vitin 2016, por që nuk janë reflektuar në ndryshimet e Kodit Zgjedhor. Gjetjet dhe sugjerimet për përmirësimet e kuadrit ligjor ekzistues, vijnë në vlerësim të eksperiencës institucionale, sikundër edhe angazhimit të vijueshëm institucional në funksion të një përqsasjeje më të mirë, më të saktë dhe më rezultative, me synim rritjen e standarteve të proceseve zgjedhore.

III.3 Sugjerime për përmirësime në Kodin Zgjedhor, nisur nga problematikat e hasura në zgjedhje

KQZ ka hartuar një paketë rekomandimesh të cilat kanë dalë gjatë punës për organizimin e zgjedhjeve.

- Rishikimi i afateve për regjistrimin e kandidatëve. Në çdo proces rregjistrimi i subjekteve zgjedhore, ndjekja e procedurave për verifikimin e dokumentacionit të listave shumëmemërore dhe ndjekja e ankimeve gjyqësore kanë vënë në rrezik prodhimin e fletëve të votimit në kohë.
- Pjesëmarrja në kurset e trajnimit të KQZ-së në periudhë jashtëzgjedhore dhe pajisja me çertifikatën përkatëse, të vlefshme, të jetë kusht për emërimin në detyrën e komisionerit zgjedhor.
- Forcimi i mekanizmave ligjorë për të garantuar respektim të afateve për propozimin e anëtarëve të komisioneve të nivelit të tretë të administratës zgjedhore (komisioni i qendrës së votimit dhe grupit të numërimit të votave).
- Përcaktimi i kuotës gjinore për propozimet për anëtarë të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe Grupit të Numërimit të Votave.
- Rishikimi i kuotës gjinore për propozimet e anëtarëve të Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor më qëllim që të garantohet 30 % kuota gjinore për përbërjen e tij në çdo rast.
- Gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës, anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, duhet të pezullohen nga detyra kur ata janë nëpunës të administratës publike, dhe për gjatë kësaj kohe duhet t'u ruhet vendi i punës.
- Zyrat e gjendjes civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, duhet të "pastrojnë" rekordet e dyshuara të dubluar në listës së zgjedhësve jo vetëm gjatë periudhës së zgjedhjeve.
- Plotësimi jo vetëm në periudhë zgjedhore, nga njësitë e qeverisjes vendore i kodit të banimit për zgjedhësit që u mungon ky kod.
- Kryerja e disa modifikimeve në sistemin teknologjik qendror në administrimin e listës së zgjedhësve sipas kërkesave logjike të auditëve teknikien për të lehtësuar përdorimin nga punonjësit e zyrave të gjendjes civile.
- Rritja e sigurisë së sistemit të teknologjisë së informacionit, zhvillimi i aplikacioneve të reja dhe mirëmbajtja e përditësimi i atyre ekzistuese.
- Rishikimi i nenit 95/1 i Kodit Zgjedhor, për të marrë në konsideratë përkufizimin e saktë të partive të shumicës parlamentare/qeverisëse dhe partive të opozitës parlamentare, të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit.
- Përcaktimin e detyrimit ligjorë për Autoritetin e Mediave Audiovizive për të mundësuar

Bordin e Monitorimit të Mediave (BMM) të monitorojë të gjitha mediat kombëtare dhe vendore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke evituar disbalancimin dhe standardet e dyfishta në monitorime dhe raportime në dy zgjedhjet e fundit.

- Rezulton se partitë politike e fillojnë fushatën zgjedhore shumë kohë më parë se përcaktimi ligjor 30 ditë para datës së zgjedhjeve. Në mënyrë që media të mos lejohet të pasqyrojë aktivitetet e partive politike në rastet kur partitë dhe subjektet zgjedhore e nisin fushatën zgjedhore kohë përpara fillimit të periudhës zgjedhore, procesi monitorues nëpërmjet Bordit të Monitorimit të Medias të përfshijë një periudhë më të gjatë se periudha zgjedhore. Gjithashtu Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë një formulim të qartë të ndalimit të pasqyrimin në media të veprimtarive me karakter elektoral, jashtë periudhës së fushatës zgjedhore dhe sanksionet përkatëse në rast të shkeljeve të tyre.
- Kodi Zgjedhor nuk parashikon monitorimin e shtypit të shkruar, të printuar dhe online. Gazetat e printuara dhe portalet online nuk monitorohen përse i përket mbulimit të fushatës zgjedhore të subjekteve që marrin pjesë në zgjedhje. Mediat online dhe shtypi i shkruar i printuar kanë një impakt shumë të madh tek zgjedhësit, ndaj si rrjedhojë Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë monitorimin e pasqyrimin të fushatës së partive politike dhe kandidatëve edhe në shtypin e shkruar, të printuar dhe online (elektronik).
- Të rishikohet mënyra e emërimit të anëtarëve të BMM duke e bërë procesin më transparent, më gjithëpërfshirës dhe më profesional. Gjithashtu, duhet të vendoset si kriter respektimi i kuotës gjinore për zgjedhjen e anëtarëve të këtij Bordi.
- Kodi Zgjedhor duhet të përcaktojë detyrimin e partive politike, të cilat brenda kohës që u vohet falas nga operatorët audio-vizivë, gjysmën e 3-% të saj, ta vënë në dispozicion për kandidatet femra.
- Trajnimi i gazetarëve, redaktorëve dhe punonjësve të medias që merren drejtpërdrejt me fushatat zgjedhore, duhet të bëhet i detyrueshëm sepse mosnjohja e tyre e Kodit Zgjedhor, sistemit administrues, dhe aspekte të tjera që lidhen me integritetin e procesit zgjedhor, sjellin desinformim të opinionit publik dhe dengrim të procesit zgjedhor.
- Të përfshihen në monitorim edhe emisionet e vecanta televizive (si ato satirike) pasi emisione të tilla përveç informacionit transmetojnë komente, opinione, qëndrime politike ku sjellin denigrimin e kandidatëve dhe subjekteve zgjedhore duke sjellë ndikim të drejtpërdrejtë tek zgjedhësit.
- Të parashikohet në Kodin Zgjedhor, si një nga masat administrative paraprake për operatorët audio-vizivë privatë, kompensim të kohës së transmetimit për balancimin e kohës televizive.
- Nevojitet harmonizimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor nenit 84, pika 1 dhe nenit 24, pika 5 të ligjit "Për partitë politike" në lidhje me transmetimin e reklamave në radiotelevizionet private.

PJESA IV - VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-SË

IV.1 Marrëdhëniet me institucionet e tjera

Bashkëpunimi dhe ndërveprimi i KQZ me institucione të tjera, të ngarkuara ose jo me detyra nga Kodi Zgjedhor, edhe për zgjedhjet për Kuvend 2017 shënoi nivel të lartë, si praktikë tashmë e konsoliduar për çdo proces zgjedhor dhe shprehje vullneti për mbarëvajtjen e zgjedhjeve.

KQZ shpreh falenderime për të gjithë institucionet shtetërore që me angazhimin dhe kontributin e tyre, ishin një vlerë e shtuar në përmbushjen me sukses dhe në kohë të detyrave, dhe në veçanti për:

Policinë e Shtetit, për kryerjen me korrektësi të detyrave që Kodi Zgjedhor i ngarkon për garantimin e rregullit dhe të qetësisë në çdo ambient zgjedhor, veçanërisht në Qendrat e Votimit gjatë ditës së votimit, në Vendet e Numërimit të Votave, shkëmbimin korrekt dhe në kohë reale të informacionit për çdo rast të evidentimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin. Në zbatim të përcaktimeve të kuadrit ligjor, KQZ dhe Policia e Shtetit shkëmbyen informacione me të dhëna të plota për objektet zgjedhore dhe adresat e vendndodhjeve të tyre, si dhe të dhëna të plota për punonjësit e Policisë së Shtetit që do të angazhoheshin, sipas detyrës dhe objektit zgjedhor ku ishin caktuar.

Ministrinë e Arsimit, për vënien në dispozicion të ambienteve të shkollave për: krijimin e selive të KZAZ-ve, qendrave të votimit, vendeve të numërimit të votave, për realizimin e trajnimeve për komisionerët zgjedhorë, si dhe veçanërisht për vënien në dispozicion të kompjuterave PC për KZAZ selitë e të cilave ishin në shkolla.

Ministrinë e Mbrojtjes, për angazhimin në realizimin e transportin e bazës materiale zgjedhore, nga KQZ-ja në KZAZ-të, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe anasjelltas.

OSHEE, për garantimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike të objekteve zgjedhore, përgjatë gjithë procesit zgjedhor, dhe veçanërisht të Qendrave të Votimit.

Autoritetin e Mediave Audiovizive, për vënien në dispozicion të BMM të kapaciteteve teknike për nevoja të monitorimit të fushatës zgjedhore, në radion dhe televizionin publik dhe privat, për regjistrimin e programeve të operatorë televizivë në mënyrë dixhitale.

Prokurorinë e Përgjithshme, për shkëmbimin e informacionit për raste apo sjellje që cënuan zhvillimin e zgjedhjeve demokratike.

Institucionet e Prefektëve, për sigurimin e ambienteve të punës për Zyrat Rajonale Zgjedhore.

Institutin e Ekspertëve Kontabël të Licensuar (IEKA) për vënien në dispozicion të ekspertizës dhe kapaciteteve njerëzore për realizimin e monitorimit të financave të partive politike.

IV.2 Partneriteti, KQZ - Organizma Ndërkombëtare

Komunikimi me faktorin ndërkombëtar dhe vëzhguesit ka qenë i pandërprerë dhe transparent. Ky bashkëpunim vijoi të jetë pjesë e rëndësishme e veprimtarisë KQZ-së edhe për zgjedhjet për Kuvendin në 2017. Ndër bashkëpunimet më të rëndësishme evidentohen:

Bashkëpunimi me Këshillin e Evropës

- Një sistem telefonik hotline (qendër thirrjeje) për grumbullimin e ankesave publike (përmes linjës fikse) për praktikat ilegale të hasura gjatë administrimit të zgjedhjeve;
- Aplikacioni "VOTO 2017" synoi realizimin e një informimi dhe komunikimi interaktiv kryesisht për votuesit e rinj që janë edhe përdoruesit më të shumtë të teknologjisë së informacionit.
- Rikthimi i faqes së internetit të KQZ-së për ta bërë atë më të lehtë për përdorim dhe të lehtë për t'u administruar.

- Fasilitetet në trainimin/ edukimin dhe infrastrukturën e trajnimit të KQZ-së.
- organizimin në bashkëpunim me KQZ të konferencës pas-zgjedhore e cila u përqëndrua në gjetjet dhe rekomandimet kryesore të raporteve përfundimtare të OSBE/ODIHR-it dhe Asamblesë Parlamentare të KiE.

Bashkëpunimi me Bashkimin Evropian

Projekti i binjakëzimit "Mbështetje për ndërtimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave anti-korrupsion", është projekti më i madh anti-korrupsion i këtij lloji në vendet e Ballkanit, i financuar me një shumë prej 3 (tre) milion Euro nga Bashkimi Evropian. Binjakët e Shqipërisë në projektin aktual janë Austria dhe Gjermania. Ato do ta mbështesin Shqipërinë gjatë 29 muajve të ardhshme në luftën kundër korrupsionit. Me KQZ është realizuar:

* Workshop-i mbi financat e partive politike dhe fushatave elektorale.

Gjithashtu në kuadër të strukturës horizontale të Këshillit të Evropës / Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, "**Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri**" kontribuoi në forcimin e legjislacionit për financimin e Partive Politike dhe Fushatat Zgjedhore, duke ofruar rekomandime të cilat synonin për të siguruar një ndikim të qëndrueshëm të reformës zgjedhore.

Projekti i realizuar me ekspertizën e KiE dhe NDI mbështeti kapacitetet mbikëqyrëse të KQZ-së për kontrollin dhe verifikimin e raporteve financiare të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore përmes:

- hartimit të kuadrit rregullator dhe metodologjik, duke përkrahur KQZ-së në hartimin e akteve nënligjore (udhëzimeve) pas ndryshimeve në Ligjin për Partitë Politike.
- ngritjes së kapaciteteve të ekspertëve financiarë të KQZ-së dhe organizatave të shoqërisë civile lidhur me monitorimin e financimit të fushatës zgjedhore në mënyrë efektive.

Bashkëpunimi me UN Women

- Mbështetje për Konferencat vjetore të Shoqatës së Zyrtarëve Zgjedhorë për Evropën (ACEEEO) - Konferenca e 26-të e zhvilluar në Sofie të Bullgarisë.
- Bashkëpunimi me UN Women, për prodhimin e spotit për ndërgjegjësimin e zgjedhësve gra. KQZ realizoi një spot të vecantë televiziv, i cili u transmetua përgjatë muajit qershor 2017 në fasha orare me audiencë, dhe që përcolli për zgjedhëset gra të të gjitha moshave dhe profesioneve, gratë e zonave rurale, gratë shtëpiake, informacione dhe mesazhe sensibilizuese për pjesëmarrje në votim dhe ushtrimin e të drejtës së votës në mënyrë të pandikuar.
- Raporti post zgjedhor i KQZ-së për Zgjedhjet e 25 qershorit 2017.

Bashkëpunimi me Prezencën e OSBE-së.

- Me iniciativë të Pranisë së OSBE-së dhe mbështetjen e KQZ-së, është mbledhur rregullisht Election Working Group, një grup pune, i cili ka si qëllim koordinimin e pjesëmarrësve në identifikimin e nevojave të KQZ-së dhe të shoqërisë civile për dhënien e asistencës parazgjedhore në fushat në të cilat ishte më e nevojshme mbështetja për angazhimin në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.
- Bashkëpunimi me Prezencën e OSBE-së për mbështetjen e realizimit të projektit edukues për komunitetet rome dhe egjiptiane, si dhe për realizimin dhe transmetimin e spotit televiziv ndërgjegjësuës për veprat penale në zgjedhje.

Bashkëpunimi me UNDP

- Në pjesëmarrjen e përfaqësuesve të KQZ në Konferencën vjetore e ACEEEO-s së bashku me UN Women e zhvilluar në Sofie të Bullgarisë.

Bashkëpunimi me USAID

Që prej vitit 2013 KQZ ka filluar të ndërtojë Sistemin e Integruar të Manaxhimit Elektronik të Informacionit Zgjedhor (IEMIS). Me ndihmën e donatorëve, kryesisht USAID, janë zhvilluar deri tani pothuajse të gjitha modulet kryesore të këtij sistemi dhe po punohet për mirëmbajtjen dhe të mundësohet zhvillimi i moduleve të tjera.

Bashkëpunimi me Ambasadën Gjermane

Për këto zgjedhje pati dhe një investim prej rreth 13 mijë euro nga Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë për pajisjet e firewall-router dhe furnizimi me energji të pandërprerë në rast të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike. Rritja e sigurisë dhe performancës së sistemit të teknologjisë, ka një rëndësi të veçantë për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe pajisjet që mori KQZ nga projekti me Ambasadën Gjermane, ndihmuan pikërisht për rritjen e sigurisë dhe performancës gjatë transmetimit të rezultateve paraprake.

IV.2.1 Vëzhgimi i proceseve zgjedhore

Ndarja e eksperiencave pozitive në trajtimin e mjaft problematikave me të cilat përballen sot Trupat e Menaxhimit të Zgjedhjeve në rajon e më gjerë me synim shkëmbimin e përvojave dhe nxjerrjen e mësimëve pozitive ka qenë dhe fokusi i disa aktiviteteve të zhvilluara si vijon:

- *Konferencën rajonale "Teknologjia në zgjedhje" e cila u zhvillua në Prishtinë.* Konferenca ofroi një mundësi për Trupat Menaxhuese Zgjedhore të rajonit për të shkëmbyer përvojat e tyre për teknologjinë në zgjedhje, duke përfshirë sistemin elektronik të identifikimit të votuesit, identifikimit biometrik të votuesve, numërimit elektronik të votave dhe transmetimi i drejtëpërdrejtë i rezultateve paraprake.
- Mbledhja e 3-të e Asamblesë së Përgjithshme të A-WEB dhe konferenca dy ditore "Numërimi i fletëve të votimit dhe përdorimi i teknologjisë për rritjen e transparencës së proceseve zgjedhore", punime të cilat u zhvilluan në Bukuresht të Rumanisë.
- Vëzhgimi i zgjedhjeve presidenciale në Slloveni - 22 Tetor 2017 (raundi i parë) dhe 12 nëntor 2017 (raundi i dytë).
- Vëzhgimi i zgjedhjeve vendore në Kosovë me ftesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës më 22 tetor 2017.

IV.2.2 Përfaqësimi i KQZ-së në aktivitetet e Mekanizmave Ndërkombëtar Zgjedhore

Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare i ka shërbyer shkëmbimit të eksperiencave dhe ka rritur dhe më shumë vlerësimin për KQZ-Shqipëri, duke zhvilluar imazhin dhe reputacionin e saj në planin rajonal, evropian dhe më gjerë ku vlen për t'u theksuar ri-zgjedhja e KQZ-Shqipëri në:

Bordin Ekzekutiv të A- WEB (Shoqata Botërore e Trupave Zgjedhore)

Anëtarët e Bordit Ekzekutiv janë të ftuar të japin vlerësimet e tyre lidhur me veprimtarinë e shoqatës si dhe të shfaqin opinionet e tyre lidhur me strategjitë e sukseshme të cilat do ndiqen

në të ardhmen për administrimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në të gjitha vendet anëtare përfshirë dhe Shqipërinë.

Konferenca e 26-të e ACEEEO, nëntor 2017, Sofie të Bullgarisë

Me ftesë të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës së Zyrtarëve Zgjedhore Europianë (ACEEEO), në kuadër të zhvillimit të Konferencës së 26-të Vjetore dhe Takimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës së Zyrtarëve Zgjedhore Europianë (ACEEEO), e cila zhvilloi punimet në datat 8-10 nëntor në Bullgari, mori pjesë në cilësinë e anëtarit edhe delegacioni i KQZ-së. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i Shqipërisë, është një nga vendet themeluese dhe anëtare të ACEEEO-s dhe konferenca vjetore është aktiviteti më i rëndësishëm i saj në bashkërendimin e projekteve dhe nismave zgjedhore si dhe në ngritjen profesionale të zyrtarëve zgjedhorë të shteteve pjesëmarrëse. Zyrtarë të lartë zgjedhorë të Trupave të Administrimit Zgjedhor të vendeve të ndryshme të botës si dhe eksperte zgjedhorë, e trajtuan temën "Votuesit e Ndërgjegjshëm në Epokën Dixhitale", duke referuar eksperiencat dhe praktikat më të mira nga zgjedhjet e zhvilluara në vende të ndryshme gjatë vitit 2017. Në fokus të referimeve ishte roli i Trupave të Menaxhimit të Zgjedhjeve në ndërgjegjësimin e votuesve në epokën dixhitale; mënyrat e reja të informimit të votuesve; nevoja të veçanta të votuesve të rinj.

IV. 3 Botimi i Raportit për zgjedhjet për Kuvend 2017

Në frymë të përgjegjshmërisë për përbushjen e misionit institucional, KQZ ka në fokus dhe punon intensivisht për edukimin zgjedhor të shtetasve shqiptarë, për forcimin e kulturës zgjedhore për të vlerësuar dhe ushtruar të drejtën e votës, dhe rritjen e besimit të tyre tek administrata zgjedhore. Zgjedhësit janë aktorët kryesorë të procesit zgjedhor, dhe në respekt të informimit të tyre, KQZ për herë të parë realizon botimin e Raportit me informacion për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin të mbajtura në 25 qershor 2017. Ky raport, si një risi për rritjen e transparencës dhe ndërveprimet eficient të KQZ me zgjedhësit edhe aktorët e përfshirë në zgjedhje, nuk zëvendëson dhe as nuk mbivendoset me raportime të tjera të bëra si nga organizmat e huaja ndërkombëtare ashtu edhe nga ato vendase, por synon të jetë komplementar me to, në funksion të plotësisë së tabllës për ecurinë e procesit zgjedhor. Ky raport, duke pasyruar në mënyrë të përmbledhur dhe kronologjike punën e administratës zgjedhore të udhëhequr nga KQZ, për të përgatitur organizuar dhe administruar në mënyrë të sukseshme zgjedhjet për Kuvend të datës 25 qershor 2017, evidenton arritje dhe probleme, zgjidhja e të cilave shënon sfidat e së ardhmes për të përmirësuar administrimin e zgjedhjeve, dhe përbushur pritshmëritë, së pari të zgjedhësve shqiptarë, për rritjen e standarteve të zgjedhjeve në Shqipëri! Botimi i Raportit të KQZ-së për zgjedhjet për Kuvendin 2017, u mundësua falë asistencës dhe mbështetjes së UN Women, një nga organizmat partnere të KQZ-së.

PJESA V - PLOTËSIMI I VAKANCAVE TË KRIJUARA NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Për plotësimin e vakancave të njoftuara nga Kuvendi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim, në zbatim të Nenit 164 të Kodit Zgjedhor. Ky nen përcakton, se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës, dhe KQZ merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës, në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Gjatë vitit 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë 7 (shtatë) zëvendësime vakancash të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë, për shkak të ndërprerjes së mandatit të deputetëve si më poshtë vijon:

1. Me vendimin nr.01, datë 06.01.2017, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës, në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Vlorë, z.Flamur Rrapo Çelaj, për shkak të heqjes së mandatit të deputetit z. Shkëlqim Selami, në kuadër të plotësimit të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë për këtë qark.
2. Me vendimin nr.02, datë 06.01.2017, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës, në listën shumemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Qarku Vlorë, z. Edmond Skënder Zejno, për shkak të heqjes së mandatit të deputetit z. Dashamir Tahiri, në kuadër të plotësimit të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë për këtë qark.
3. Pas njoftimit të vakancës të krijuar në Kuvend për përfundimin e parakohshëm të deputetit z. Armando Prenga, KQZ në zbatim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, nenit 11 të ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe Kreu II, pika 3 të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me vendimin nr.64, datë 20.03.2017, ka vendosur të shpallë mos zgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, Qarku Lezhë, Z.Kastriot Filip Piroli, pasi kandidati nuk depozitoi, brenda afatit formularin e vetëdeklarimit. Me shpalljen e mos zgjedhshmërisë si deputet i Kuvendit, të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, Qarku Lezhë, Z. Kastriot Filip Piroli, rezultoi se lista e kandidatëve të Partisë Socialiste, në zonën zgjedhore qarku Lezhë, ka shteruar. Sipas nenit 164, pika 4 të Kodit Zgjedhor, në rast se lista e kandidatëve të partisë politike, anëtare e një koalicioni ka shteruar, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.93, datë 27.03.2017, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës, në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Lezhë, z. Petrit Preng Gjoni, për shkak të përfundimit të mandatit të deputetit z. Armando Prenga, në kuadër të plotësimit të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë për këtë qark.

4. Me vendimin nr.102, datë 29.03.2017, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës, në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Fier, z. Xhevit Qemal Bushaj, për shkak të heqjes së mandatit të deputetit z. Ervin Koçi, në kuadër të plotësimit të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë për këtë qark.
5. Me vendimin nr.551, datë 19.07.2017, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës, në listën shumemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, Qarku Lezhë, z. Zef Gjergj Maçi, për shkak të humbjes

së jetës të deputetit z. Gjovalin Kadeli, në kuadër të plotësimit të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë për këtë qark.

6. Me vendimin nr.554, datë 24.07.2017, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës, në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Fier, z. Artur Hasan Çobani, për shkak të përfundimit mandatit të deputetit z. Arben Çuko, në kuadër të plotësimit të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë për këtë qark.
7. Me vendimin nr.573, datë 06.12.2017, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës, në listën shumëmemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Qarku Elbasan, znj. Elena Josif Xhina, për shkak të përfundimit mandatit të deputetit z. Bujar Muça, në kuadër të plotësimit të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë për këtë qark.

Shtatë kandidatët për deputet kanë paraqitur në KQZ formularët e vetëdeklarimit, të cilët janë plotësuar e verifikuar në bazë të përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015".

PJESA VI - ORGANIZIMI I ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KAVAJË

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr.10098, datë 24.03.2017 caktoi datën 07.05.2017, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kavajë, Qarku Tiranë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, menjëherë pas caktimit të datës së zgjedhjeve të pjesshme, për kryetarin e Bashkisë Kavajë mori të gjitha masat për organizimin e zgjedhjeve ditën e diel më datë 7 maj, në përputhje me caktimet ligjore të Kodit Zgjedhor.

- U ngrit KZAZ nr. 42, Bashkia Kavajë, ku sekretari u emërua kryesisht nga KQZ, pas zhvillimit të procedurave ligjore për shprehje interesi të shtetasve për emërimet "kryesisht";
- U përgatit e gjithë baza materiale zgjedhore për funksionimin e KZAZ nr. 42, të 85 KQV, dhe GNV, e cila u dërgua pranë KZAZ nr. 42, Bashkia Kavajë më datë 4 maj 2017;
- U prodhuan 62 937 fletët e votimit;
- U trajnuan anëtarët e KQV, përfshirë edhe shtetasit që aplikuan për tu emëruar kryesisht si anëtarë të KQV.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 42 më datë 06.05.2017, njoftoi zyrtarisht KQZ-në se Z. Klodian Agron Shehi, kandidatë për kryetar i bashkisë Kavajë, propozuar nga Partia Socialiste dhe z. Astrit Muharrem Haka, kandidat për kryetar i Bashkisë Kavajë, i mbështetur nga zgjedhësit kishin paraqitur deklaratat noteriale për dorëheqjen e tyre si kandidat për kryetar të Bashkisë Kavajë. KZAZ nr.42, pas shqyrtimit të dorëheqjeve me vendimin e saj nr.177, datë 05.05.2017, vendosi pranimin e dorëheqjeve dhe çregjistrimin e tyre.

Me datë 7 maj 2017, si pasojë e tërheqjes nga zgjedhjet e pjesshme të kandidatëve, KZAZ nr. 42 njoftoi KQZ-ne për ndodhitë si më poshtë:

- Komisionet e Qendrave të Votimit të Zonës Zgjedhore Bashkia Kavajë, nuk u paraqitën pranë KZAZ-nr. 42, ditën e shtunë një ditë para datës së zgjedhjeve për tërheqjen e bazës materiale zgjedhore;
- Në orën 07.00, i cili është orari i fillimit të votimit, nuk u hap votimi në asnjë qendër votimi;
- Deri në orën 13.00 të datës 7 maj 2017, nuk u hap asnjë qendër votimi dhe nuk filloi votimi në asnjë prej tyre.

Në këto rrethana të njohura botërisht por edhe të formalizuara nga KZAZ nr. 42, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstatoi se procesi i zgjedhjeve të pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kavajë, i dekretuar nga Presidenti i Republikës, për tu zhvilluar në datë 7 maj 2017 nuk u zhvillua. Me vendimin nr.307 datë 19.05.2017 "Për konstatimin e përfundimit pa votim dhe pa rezultat të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kavajë të datës 7 maj 2017", KQZ vendosi të konstatoj përfundimin pa votim dhe pa rezultat zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kavajë të datës 7 maj 2017.

Me Dekretin nr.10352, datë 21.05.2017 Presidenti i Republikës së Shqipërisë, caktoi datën 25.06.2017, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetarin e bashkisë Kavajë, qarku Tiranë.

Zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Kavajë u zhvilluan në të njëjtën ditë me zgjedhjet për Kuvendin. Për zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Kavajë, funksionuan të njëjtët komisione të niveleve të dyta e të treta të ngritura për zgjedhjet për Kuvendin, si u përdorë e njëjta Kuti e materileve zgjedhore. Për specifika të vecanta që kanë zgjedhjet kur organizohet njëkohësisht për dy organe, si administrimi fletës së votimit të hedhur në kutinë e gabuar dhe pasqyrimi në tabelën e rezultateve të këtyre rasteve, u miratua dhe përgatit dokumentacioni zgjedhor përkatës, në një kohë relativisht të shkurtër dhe të ngarkuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, menjëherë pas dekretimit nga Presidenti i Republikës të datës për zhvillimin e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Kavajë, miratoi planin e veprimit, për kohën e miratimit të akteve të nevojshme nënligjore, për organizim dhe administrim të këtij procesi të pjesshëm zgjedhor.

KQZ nxorri 29 vendime, përmes të cilave:

- Miratoi afatet procedurale për procesin e pjesshëm zgjedhor për Kryetarin e Bashkisë Kavajë;
- Regjistroi si subjekte zgjedhore 3 parti politike;
- Caktoi partitë politike që do të propozonin anëtarët e KZAZ-së nr.42;
- Emëroi Kryetarin, Zv. Kryetarin, anëtarët dhe sekretarin e KZAZ 42;
- Miratoi dokumentacionin e punës që do të përdorej nga KZAZ-të dhe KQV-të;
- Miratoi dokumentacionin e kandidimit;
- Miratoi caktimin e 3 Qendrave të Votimit në Ambiente private;
- Caktoi vendndodhjen e Vendit të Numërimit të Votave;
- Miratoi përmbajtjen e fletës së votimit me tre kandidatë për Kryetar Bashkie;
- Miratoi sasinë e fletëve të votimit;
- Miratoi përdorimin e kamerave regjistruese dhe bazën materiale zgjedhore që do të përdorej;
- Shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Numërimi i votave për kryetarin e Bashkisë Kavajë u zhvillua menjëherë pasi mbaroi numërimi i votave të kutive të votimit për Kuvendin e Shqipërisë. Megjithë specifikat procedurale, numërimi i votave për zgjedhjet e pjesshme u krye korrektësisht, pa dëshmuar problematika. Baza materiale zgjedhore e këtyre zgjedhjeve u dorëzua në KQZ bashkë me bazën materiale zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme

**PJESA VII - VERIFIKIMI I VETË DEKLARIMEVE TË FUNKSIONARËVE
(DEKRIMINALIZIMI) NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 'PËR GARANTIMIN E
INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË
FUNKSIONE PUBLIKE**

1. Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit për zgjedhjet për Kuvendin 2017

Zgjedhjet për Kuvendin 2017, ishin zgjedhjet e para ku u zbatua dhe ligji "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Ligji përmban dispozita të cilat garantojnë integritetin e figurës së kandidatëve duke ndaluar kandidimin për t'u zgjedhur në funksione publike deputetit, kryetarit të bashkisë ose anëtarit të këshillit bashkiak, të personave të cilat kanë kryer veprime ose mosveprime që përbëjnë vepër penale, sipas disa dispozitave të cituara në mënyrë shteruese në këtë ligj.

Për zgjedhjet për Kuvendin 2017 depozituan listat shumëmemore të kandidatëve për deputet, 18 parti politike, në total 2723 kandidatë. Kandidatët depozituan në KQZ, përvec dokumentacionit të kandidimit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor dhe formularët e vetëdeklarimit, sipas formatit të miratuar me vendimin e Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", brenda afateve të përcaktuara.

KQZ brenda afatit të parashikuar nga neni 73 i Kodit Zgjedhor për verifikimin e rregullsisë së dokumentacionit të kandidimit, mbështetur në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin e Kuvendit nr.17/2016 kërkoi informacion për të gjithë kandidatët për deputet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, përkatësisht për historinë e ndryshimit të gjenealiteteve dhe për gjendjen gjyqësore të tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit për 2723 kandidatë (formularit të vetëdeklarimit, dokumentacionit të depozituar nga vetë subjekti, vërtetimit të gjendjes gjyqësore dhe të gjendjes civile), rezultoi se:

- 57 prej tyre kishin dënime me burgim me vendim të formës së prerë.
- 2666 kandidat nuk kishin të deklaruar asnjë të dhenë që përfshihet në kushtet e nenit 2, pika 1 dhe 2 të ligjit 138/2017, për ndalimin e kandidimit.

Nga 57 kandidatë që rezultuan me dënime 24 ishin kandidatë femra dhe 33 kandidat ishin meshkuj

Kandidatët të cilët rezultuan me dënime me burgim me vendim të formës së prerë u zëvendësuan nga partia politike që i kishte përfshirë në listat shumëmemore brenda afatit të parashikuar nga neni 73 i Kodit Zgjedhor për korrigjimin e dokumentacionit të kandidimit. Gjatë vitit 2017, Prokuroria e Përgjithshme në shkurt të vitit 2017, i ka kërkuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për dy deputet të Kuvendit të Shqipërisë

Pas verifikimit të formularit në përputhje me nenin 15, pika 1 të ligjit 138/2015 dhe Kreu VI, pika 6 Kreu V, pika 3, germa b e Vendimit të Kuvendit 17/2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi t'ia kaloj rastin për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme.

Me datë 26.12.2017 Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Mardhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit të Integritetit, dërgoi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimet e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit 138/2015 për dy Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

Sipas Prokurorisë së Përgjithshme të dy deputet nuk kishin deklaruar në Formularin e vetëdeklarimit ndalime, hetime dhe përdorim të identitetit të remë në shtetin Italian.

Subjektet nuk e kishin deklaruar këtë informacion, dhe pse kishin patur detyrimin ligjor për ta pasyruar në formularin e vetëdeklarimit dhe konkretisht në pikën 3 të formularit "A keni qënë ndonjëherë në hetim po gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?" dhe pikën 4 të formularit, "A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale?", i janë përgjigjur me "Jo" të dyja pyetjeve më sipër.

Në KREUN III, pika 3, ç), të vendimit të Kuvendit 17/2016, thuhet se formulari (që plotësohet dhe firmoset nga subjektet vetëdeklarues) përmban një rubrikë që detyrimisht pasqyrohet se "...pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të, pasjell përjashtimin e menjëhershë dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik".

Fakti që në formularin e vetëdeklarimit, nuk është pasqyruar asnjë e dhënë e përcjellë në lidhje me ndalimet dhe hetimet përkatëse në shtetin Italian, si dhe identitetim e rremë të përdorur nga vetë ata, me të cilin është dyshuar se kanë konsumuar vepër penale, bën që subjekti të përfshihet në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik Kjo pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga funksioni publik që mban.

KQZ, pasi shqyrtoi dokumentacionin në kuadër të zbatimit të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, informacioni i ardhur nga institucioni i Prokurorisë krijoi bindjen se funksionarët kanë shkelur dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me zbatimin e drejtë, transparencën dhe frymën me të cilën funksionon ligji nr. 138/2015 "Për verifikimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike", dhe rregullimet e detajuara të parashikuara në vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar gërmës c, pikës 3, Kreut III të vendimit të Kuvendit nr.17/2016, ishin në kushtet për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me vendimet nr.3, datë 05.01.2018 dhe nr.4, datë 05.01.2018, vendosi për të dy rastet të shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit.

2.Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtar të këshillave bashkiak, gjatë procesit të plotësimit të vakancave të krijuara.

Gjatë vitit 2017 KQZ në zbatim të nenit 11 të Ligjit nr.138/2015, ka verifikuar formularët e vetëdeklarimit dhe për 79 kandidat të listave shumemërore për këshillat bashkiak. Gjatë vitit 2017 në 79 raste këshillat bashkiak kanë njëoftuar KQZ për plotësimin e vakancave. KQZ

mbështetur në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin e Kuvendit nr.17/2016 kërkoi informacion për të gjithë kandidatët për Këshillat Bashkiak nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, përkatësisht për historinë e ndryshimit të gjenealiteteve dhe për gjendjen gjyqësore të tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit për 79 kandidatë (formularit të vetëdeklarimit, dokumentacionit të depozituar nga vetë subjekti, vërtetimit të gjendjes gjyqësore dhe të gjendjes civile), rezultoi se:

Nga verifikimi i dokumentacionit për 79 kandidatë (formularit të vetëdeklarimit, dokumentacionit të depozituar nga vetë subjekti, vërtetimit të gjendjes gjyqësore dhe të gjendjes civile), rezultoi se:

- 77 kandidatë u dha autorizimi për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit
- 2 kandidat u konstatuan në kushtet e mosgjydhshmërisë.